

ARSIMI I TË RRITURVE NË KOSOVË*

Fletë informuese

Ky raport është përgatitur për Fondacionin Evropian për Trajnim (ETF) nga Teuta Danuza, me kontributin e Maria Carmo Gomes. Siria Taurelli nga ETF ka udhëhequr procesin e hartimit dhe ka rishikuar draftin e raportit.

Dorëshkrimi u përfundua në Mars 2026.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e ETF-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të BE-së.

© Fondacioni Evropian për Trajnim, 2026



Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është i autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC BY 4.0)

<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/> [https://creativecommons.org/licenses/by/4.0.](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/) Kjo do të thotë se ripërdorimi lejohet me kusht që të jepet referenca e duhur dhe të tregohet çdo ndryshim i bërë. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive apo materialeve të tjera që nuk janë në pronësi të Fondacionit Evropian për Trajnim, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga mbajtësit e të drejtave të autorit.

Deed – Attribution 4.0 International – Creative Commons.

Kur të citoni këtë raport, ju lutemi përdorni formulimin në vijim:

Fondacioni Evropian për Trajnim (2026), *Arsimi i të Rriturve në Kosovë*, Torino.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
HYRJE	5
Konteksti vendor	6
KAPITULLI I: STRATEGJITË DHE POLITIKAT PËR ARSIMIN E TË RRITURVE	7
Strategjitë	7
Korniza Ligjore	9
Politikat e Arsimit të të Rriturve	11
Performanca kombëtare kundrejt objektivave kyçe të BE-së për Arsimin e të Rriturve	12
Përfundime	15
KAPITULLI II: RREGULLIMET INSTITUCIONALE DHE QEVERISJA NË ARSIMIN E TË TË RRITURVE	17
Regullimet institucionale	17
Modeli i qeverisjes së Arsimit të të Rriturve	18
Financimi i Arsimit të të Rriturve	19
Monitorimi dhe Sigurimi i Cilësisë	20
Përfundime	21
KAPITULLI III: OFRIMI I ARSIMIT PËR TË RRITUR	23
Llojet dhe programet e Arsimit të të Rriturve	23
Masat dhe shërbimet mbështetëse për kandidatët e rritur	24
Përfundime	26
PËRFUNDIME	27
SHTOJCA I – KORNIZA ANALITIKE DHE PYETJET UDHËZUESE	28
SHTOJCAT II - LISTA E INTERVISTUESVE	31
SHTOJCA III – VLERËSIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA: 2022 – 2024	32
SHTOJCA IV – ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË ARR NË KOSOVË	33
SHTOJCA V – PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL NË ORGANET E QEVERISJES, DREJTIMIT DHE KOORDINIMIT NË NËN-SEKTORIN E ARR	35
SHTOJCA VI – BURIMET E FINANCIMIT NGA BUXHETI I SHTETIT, NË NIVEL QENDROR DHE KOMUNAL	36

SHTOJCA VII – PËRMBLEDHJE E OFRIMIT TË ARSIMIT TË TË RRITURVE NË KOSOVË	37
SHTOJCA VIII – TABELA STATISTIKORE : PJEËMARRJA DHE CERTIFIKIMI	38
AKRONIMET	39
REFERENCAT	41

HYRJE

Fleta informuese është zhvilluar në vitin 2025 nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), në kuadër të një ushtrimi rajonal për hartëzimin e arsimit të të rriturve (ARr), i realizuar në vendet kandidate dhe potencialisht kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përkatësisht: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova¹, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Ukraina.

Ky projekt e trajton ARr-në si një sektor me rëndësi në rritje, në kontekstin e transformimeve të vazhdueshme shoqërore dhe ekonomike, si dhe të kërkesës gjithnjë e më të lartë për monitorim dhe raportim të reformave që synojnë ngritjen e aftësive, ri-aftësimin, si dhe zhvillimin e përgjithshëm të kapitalit njerëzor.

ARr konsiderohet një komponent thelbësor i të mësuarit gjatë gjithë jetës.² Përfshin si arsimin formal (të lidhur me kualifikime të njohura), ashtu edhe mësimin joformal (kryesisht në ndërmarrje, por edhe në mjedise të tjera të të nxënësve), duke përfshirë aktivitetet për përmirësimin dhe rikualifikimin e aftësive, si dhe zhvillimin e një game të gjerë kompetencash³.

Në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve (AARr) në Republikën e Kosovës (2013), ARr rregullohet si pjesë përbërëse e sistemit kombëtar të arsimit. Ligji përcakton kornizën për ofrimin e mundësive për të rriturit për ri-kualifikim, zhvillim të aftësive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Vetë ligji përdor termin Arsimi dhe Aftësimi i të Rriturve (AARr), i përkufizuar në nenin 2 si “arsimi dhe aftësimi publik dhe privat i ofruar për të rriturit”. I rritur konsiderohet çdo person i moshës 15 vjeç e lart, ndërsa sipas nenit 6, AARr organizohet në tri forma: arsim formal, arsim joformal dhe arsim informal. Ligji përmban 22 nene që rregullojnë terminologjinë, përgjegjësitë institucionale, akreditimin e ofruesve, organizimin e programeve, financimin dhe sigurimin e cilësisë. Në këtë raport përdoret termi më i gjerë Arsimi i të Rriturve (ARr) për t'u përafëruar me përdorimin ndërkombëtar, duke mbetur në përputhje me konceptin ligjor të AARr.

Për zhvillimin e kësaj Flete informuese, është realizuar një mbledhje sistematike e informacionit përmes shqyrtimit të literaturës dhe punës në terren. Analiza është organizuar rreth kornizës analitike dhe pyetjeve udhëzuese të paraqitura në [Shtojcën I](#).

Intervista individuale janë zhvilluar gjatë muajve gusht–shtator 2025 me përfaqësues të institucioneve relevante - akterë dhe palë kyçe të interesit në fushën e ARr në Kosovë, përfshirë Agjencinë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr), ofrues formal dhe joformal të ARr-së, si përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ), drejtore shkollash dhe qendra të trajnimit për të rinj dhe të rritur. Lista e të intervistuarve është përfshirë në [Shtojcën II](#). Ky raport është validuar nga përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)⁴.

Informacioni i paraqitur në këtë dokument reflekton dhe ofron njohuri mbi tri dimensione të rëndësishme të ARr-së: **1. Strategjitë dhe politikat për Arsimin e të Rriturve; 2. Marrëveshjet institucionale dhe qeverisja; 3. Llojet dhe format e ofrimit formal dhe joformal**, dhe do të shërbejë për ETF-në dhe palët e përfshira për të identifikuar fushat prioritare për veprime të mundshme në të ardhmen ose për ofrimin e këshillimit politik.

Kjo fletë informuese paraqet elemente faktike kyçe mbi ARr në Kosovë, duke marrë parasysh tri dimensionet e përmendura më sipër.

¹ Ky emërtim është pa paragjykim ndaj çfarëdo qëndrimi mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

² Fjalori i Cedefop e përkufizon të mësuarit gjatë gjithë jetës si “çdo aktivitet mësimor i ndërmarrë gjatë gjithë jetës, në një mjedis formal, joformal apo informal, i cili çon në përmirësimin e njohurive, dijeve praktike, aftësive, kompetencave dhe kualifikimeve për arsye personale, sociale ose profesionale <https://www.cedefop.europa.eu/en/tools/vet-glossary/glossary/een-leven-lang-leren>.”

³ Aftësitë kuptohen në një kuptim të gjerë, duke përfshirë aftësi, njohuri dhe kompetenca për jetën, përtej aftësive që nevojiten vetëm për tregun e punës.

⁴ Dokumenti i referohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) si emërtimi zyrtar i Ministrisë në kohën e hartimit të tij. Në kohën e publikimit, në vitin 2026, emërtimi zyrtar është Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Konteksti vendor

Trendet kryesore socio-ekonomike dhe demografike

Republika e Kosovës është përballur vazhdimisht me sfida të tranzicionit ekonomik, të shoqëruara me pjesëmarrje të ulët në tregun e punës, shkallë të larta të papunësisë dhe varfëri të përhapur (OECD, 2025; Fondacioni Evropian i Trajnimeve, 2021). Megjithatë është shënuar progres në stabilitetin makroekonomik dhe reformat institucionale, krijimi i vendeve të punës dhe rritja gjithëpërfshirëse mbeten të kufizuara (Qeveria e Kosovës, 2024; Banka Botërore, 2023).

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, Kosova ka gjithsej 1, 585,590 banorë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2024). Vendi është i ndarë në shtatë rajone dhe 38 komuna, të cilat shfaqin dallime të theksuara territoriale dhe socio-ekonomike. Kryeqyteti, Prishtina, përfshin pothuajse një të tretën e popullsisë. Përgjegjësitë për arsimin fillor dhe të mesëm, kopshtet e fëmijëve, kujdesin shëndetësor parësor dhe institucionet sociale e kulturore ndahen me komunat, megjithatë kapacitetet lokale për ofrimin e shërbimeve cilësore mbeten të pabarabarta (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2024).

Vështrime kryesore për vendin⁵

Demografia: Kosova mbetet një nga shoqëritë më të reja në Evropë, me moshë mesatare 34.8 vjeç në vitin 2024, krahasuar me mesataren e BE-së prej 44.4 vjet. Nivelet e larta të emigrimit të të rinjve, të kombinuara me rënien e normave të fertilitetit, mund të përshpejtojnë tkurrjen e popullsisë gjatë dy dekadave të ardhshme.

Tregu i punës: Shkalla e punësimit (15–64) në Kosovë ishte 36.3% në vitin 2023, dukshëm nën mesataren e BE-së prej 75.5%. Papunësia ishte 10.9% në vitin 2023, krahasuar me 6.1% në BE, ndërsa papunësia afatgjatë dhe pjesëmarrja e ulët në fuqinë punëtore vazhdojnë të paraqesin sfida serioze.

Rinia dhe cënueshmëria: Shkalla e të rinjve jashtë punësimit, arsimit dhe trajnimit (NEET) për moshat 15–24 ishte 33.4% në vitin 2023 — një nga më të lartat në Evropë dhe gati trefishi i mesatares së BE-së (11.2%). Varfëria mbetet e përhapur, me rreth 23% të popullsisë në pragun e rrezikut nga varfëria.

Digjitalizimi dhe arsimi: Në vitin 2024, qasja në internet përfshinte 96.6% të popullsisë, megjithatë Kosova vazhdon të renditet ndër vendet me nivelin më të ulët të aftësive bazë digjitale në Ballkanin Perëndimor. Pjesëmarrja e të rriturve (25–64 vjeç) në aktivitete të të mësuarit mbeti relativisht e ulët, me një mesatare prej 11.5% gjatë viteve 2020–2023.

Urbanizimi dhe punësimi sektorial: Rreth 50% e popullsisë jeton në zona urbane, me punësim të përqendruar në tregti, bujqësi, industri dhe administratë publike. Dallimet urbane-rurale mbeten të theksuara, veçanërisht në arsim dhe qasje në punësim.

⁵ Të dhënat me rëndësi për këtë seksion u mbledhën nga burimet e mëposhtme:

(i) Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2024). Regjistrimi i Popullsisë 2024 – Rezultatet Preeliminare. Prishtinë: ASK. <https://ask.rks-gov.net>.

(ii) Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2024). Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023. Prishtinë: ASK. <https://ask.rks-gov.net>.

(iii) Qeveria e Kosovës. (2024). Strategjia e Punësimit 2024–2028. Prishtinë: Zyra e Kryeministrit. <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Employment-Strategy-2024-2028.pdf>.

(iv) Eurostat. (2024). Labour Market and Demography Statistics. Brussels: Eurostat. <https://ec.europa.eu/eurostat>.

(v) Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2025). Economic Convergence Scoreboard for the Western Balkans 2025. Paris: OECD Publishing. Available at: https://www.oecd.org/en/publications/economic-convergence-scoreboard-for-the-western-balkans-2025_bc0babf3-en/full-report/skills-cluster_92fcced8.htm.

(vi) Regional Cooperation Council (RCC). (2021). Digital Skills in the Western Balkans. Sarajevo: RCC. <https://www.rcc.int/download/docs/2021-09-Digital%20skills.pdf/93a12a4a5178324cb46c052cd5e24180.pdf>.

KAPITULLI I: STRATEGJITË DHE POLITIKAT PËR ARSIMIN E TË RRITURVE

Ky kapitull ofron një pasqyrë të objektivave kryesore të politikave, përputhshmërinë e tyre me qëllimet dhe iniciativat e BE, prioritetet kombëtare strategjike dhe të politikave, si dhe treguesit kryesorë dhe objektivat që synohen të arrihen, përfshirë krahasimin e tyre me objektivat e BE-së.

Strategjitë

Aktualisht, nuk ekziston një strategji gjithëpërfshirëse e dedikuar posaçërisht për ARr në Kosovë. Në vend të kësaj, ARr trajtohet në mënyrë të fragmentuar, e integruar brenda strategjive të ndryshme sektoriale, si ato për arsimin, punësimin, digjitalizimin, energjinë dhe përfshirjen sociale. Ndërsa kjo siguron që ARr të përfshihet në kornizat e politikave, mungesa e një strategjie të dedikuar nënkupton se nuk ekziston një vizion i qëndrueshëm, objektiva të koordinuara apo një kornizë e qartë zbatimi për të udhëhequr sektorin.

Përmbledhje e dokumenteve strategjike relevante

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2030

Strategjia përcakton vizionin e Kosovës për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke paraqitur politikat dhe masat qeveritare të nevojshme për arritjen e tij. E pozicionon arsimin cilësor dhe të qashtë si një shtyllë kyçe të zhvillimit të barabartë njerëzor dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike, duke integruar të mësuarit gjatë gjithë jetës në të gjitha objektivat e saj. Sa i përket dimensionit të ARr, Strategjia i jep përparësi zhvillimit profesional dhe kompetencave digjitale. Pjesëmarrja e mësimeve në programet e zhvillimit profesional pritet të rritet nga 25% në vitet 2019 dhe 2020 në 70% deri në vitin 2030. Ndërkohë, së paku 95% e mësimeve, stafit arsimor dhe nxënësve pritet të kenë fituar kompetenca digjitale. Deri në vitin 2030, pritet që 85% e të diplomuarve të jenë të punësuar në profesione relevante ose të regjistruar në arsimin e lartë, të mbështetur nga një përafrim më i fortë ndërmjet arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Strategjia integron gjithashtu ARr-në në objektivin e tregut të punës dhe punësimit, me fokus në zhvillimin e aftësive, reduktimin e mospërputhjeve dhe zgjerimin e të mësuarit në vendin e punës (MVP). Deri në vitin 2030, pritet që 98% e programeve të arsimit profesional të përfshijnë konsiderueshëm elemente të mësimit praktik. Ndërkohë, pjesëmarrja në fuqinë punëtore parashihet të rritet nga 37.7% në vitin 2021 në 60% në total, dhe nga 20.6% në 55% për gratë. Përqindja e të rinjve NEET parashihet të ulet nga 32.5% në vitin 2021 në 15% deri në vitin 2030.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2022–2026

PSAK shërben si kornizë gjithëpërfshirëse që udhëheq zhvillimin e të gjitha sektorëve të arsimit, përfshirë ARr. Nga gjashtë objektivat strategjike, njëra i kushtohet Arsimit dhe Aftësisht Profesional (AAP) dhe ARr-së. E pozicionon ARr-në brenda kornizës së AAP-së, me masa të fokusuar në fuqizimin e kompetencave profesionale dhe punësueshmërisë, kryesisht përmes ofruesve publikë dhe shkollave të MASHTI-it. Paralelisht, prezanton reforma në qeverisje, financim dhe sisteme informative për të përmirësuar kapacitetet institucionale, për të siguruar ofrim të qëndrueshëm dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në të dhëna si në AAP ashtu edhe në ARr. Objektiva specifike 3.5 *Përmirësimi i ofertës dhe rritja e pjesëmarrjes në ARr*, fokusohet në zgjerimin e mundësive dhe qasjes. Synimet përfshijnë zhvillimin deri në 20 programeve të reja formale dhe joformale të ARr-së, rritjen e numrit të institucioneve të AAP-së që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NJMP) nga 6 në 25 dhe rritjen e pjesëmarrjes në ARr me 30%. Progresi do të monitorohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe të dhënave nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Plani i Veprimit parasheh një sërë masash për fuqizimin e ARr, duke përfshirë trajnimin e mësimdhënësve të ARr-së dhe themelimin e dy qendrave për ARr. Oferta do të zgjerohet përmes subvencioneve për ofruesit dhe mbështetjes për grupet e cenueshme. Ndërkohë, kapacitetet e mësimdhënësve do të forcohen përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, si dhe përmes hartimit dhe akreditimit të kurrikulave dhe kualifikimeve modulare. Masat në nivel sistemi përfshijnë krijimin e një regjistri kombëtar për ARr, fushata vetëdijësuese dhe themelimin e një grupi koordinues ndërinstitucional. Së fundi, parashihet anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të ARr-së për të promovuar mobilitetin, partneritetet dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Objektivi për AAP dhe ARr ka një buxhet total prej 19.0 milionë euro për periudhën 2022–2026. Megjithatë, vetëm 5.4% e këtij buxheti është siguruar nga buxheti i shtetit, ndërsa 17.4% pritët të mbulohet përmes financimit të jashtëm, duke lënë një hendek financiar prej 77%. Nga alokimi total, 505,920 euro janë dedikuar për ARr.

Në vitin 2025, MASHTI, me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), ka përgatitur vlerësimin afatmesëm të zbatimit të pesë Objektivave Strategjike të Strategjisë së Arsimit 2022–2026, duke mbuluar periudhën 2022–2024 (MASHTI, 2025). Rezultatet e vlerësimit për objektivat specifike të ARr-së janë paraqitur në [Shtojcën III](#).

Strategjia Kombëtare e Punësimit (2024–2028)

Strategjia mbështet masa për përmirësimin e punësimit përmes politikave aktive të tregut të punës, të strukturuar në katër shtylla kryesore: zhvillimi i shkathtësive dhe përafrimi me nevojat e tregut të punës, pjesëmarrja gjithëpërfshirëse në tregun e punës, punësimi i të rinjve dhe ulja e shkallës së NEET, si dhe reforma ligjore dhe institucionale. Objektivat strategjike synojnë uljen e mospërputhjeve të shkathtësive, zgjerimin e qasjes në punë të denjë për grupet e cenueshme, modernizimin e shërbimeve të punësimit dhe forcimin e kornizës institucionale.

Sa i përket ARr, Strategjia synon rritjen me 10% të pjesëmarrjes së grupmoshës 25–64 vjeç në programe trajnimi, duke e fuqizuar të mësuarit gjatë gjithë jetës si një nxitës kyç të punësueshmërisë. Gjithashtu përfshin edhe NJMP përmes masave për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të trajnerëve dhe zhvillimin e treguesve për NJMP.

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030

E harmonizuar me Kompasën Digjital të BE-së 2030 dhe trendet globale të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Agjenda Digjitale 2030 synon ta bëjë Kosovën një shoqëri moderne digjitale dhe ekonomi digjitale konkurruese deri në vitin 2030. Në kuadër të objektivit për aftësitë digjitale, edukimi digjital konsiderohet komponent thelbësor i të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke u orientuar drejt të rriturve jashtë sistemit formal të arsimit dhe grupeve me qasje të kufizuar, si gratë, popullsia rurale dhe komunitetet pak. Janë përcaktuar objektiva të qarta, me synimin që deri në vitin 2030, 95% e qytetarëve, përfshirë edhe të rriturit jashtë arsimit formal, të zotërojnë së paku shkathtësi bazike digjitale, ndërsa 5% të jenë specialistë aktivë në fushën e TIK-ut. Megjithatë, të dhënat bazë tregojnë se vetëm 13–14% e të rriturve kishin shkathtësi bazike digjitale në vitin 2022. Objektivat synojnë arritjen e 40% deri në vitin 2025 dhe deri në 95% deri në vitin 2030. Plani gjithashtu përfshin programe trajnimi online pa pagesë për të përmirësuar kompetencat e të rriturve në fusha si e-tregtia dhe e-qeverisja.

Strategjia Kombëtare për Rininë (2024–2032)

Strategjia synon, në një perspektivë afatgjatë, fuqizimin e të rinjve (15–29 vjeç) si kontribuues aktivë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Është e strukturuar në tri plane veprimi (2024–2026; 2027–2029; 2030–2032) dhe fokusohet në forcimin e angazhimit qytetar, rritjen e fuqizimit dhe mirëqenies së të rinjve dhe krijimin e rrugëve drejt përfshirjes sociale dhe pjesëmarrjes aktive. Edhe pse ARr nuk paraqitet si një shtyllë e veçantë, është e integruar në mënyrë të tërthortë përmes një sërë ndërhyrjesh, duke përfshirë arsimin joformal dhe informal, zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve rinorë, si dhe trajnimet për aftësi jetësore në fusha si shëndeti mendor dhe riprodhues, siguria, mjedisi dhe marrëdhëniet ndërkulturore. Objektivat specifike përfshijnë hartëzimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të arsimit joformal, me synimin që të paktën 50% e programeve të përbushin standarde

të përcaktuara të cilësisë deri në vitin 2026, si dhe zgjerimin e qasjes për grupet e marginalizuara të rinjve. Po ashtu, synohet ndërtimi i kapaciteteve të punëtorëve rinorë përmes programeve të strukturuar të trajnimit për të forcuar kompetencat dhe përmirësuar cilësinë e ofrimit të arsimit joformal.

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Romë dhe Ashkali (2022–2026)

Strategjia synon përmirësimin e përfshirjes sociale të komuniteteve romë dhe ashkali në shoqëri. Strategjia është e strukturuar në pesë qëllime strategjike: arsim, punësim dhe mirëqenie sociale, shëndetësi, strehim dhe luftimin e diskriminimit. ARr për komunitetet rom dhe ashkali trajtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në kuadër të objektivit strategjik për arsim, përmes programeve të shkrim-leximit për të rritur, me një objektiv prej 40–50 pjesëmarrësish për program gjatë periudhës 2022–2024. Përveç kësaj, në kuadër të objektivit strategjik për punësim dhe mirëqenie sociale, promovohet aftësimi profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës, me synimin për të trajnuar 125 individë nga komunitetet rom dhe ashkali gjatë periudhës 2022–2024.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031

Strategjia përcakton rrugën e Kosovës drejt një sektori energjetik të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përballueshëm, plotësisht të integruar në tregun pan-evropian të energjisë. Për të fuqizuar konsumatorët, strategjia integron ARr-në duke promovuar njohuritë mbi energjinë dhe trajnime të specializuara në fusha që lidhen me energjinë. Parashihet bashkëpunim i ngushtë ndërmjet akademisë, industrisë dhe partnerëve zhvillimorë për hartimin dhe ofrimin e programeve të trajnimit në energji të ripërtëritshme, tregjet e energjisë elektrike dhe eficiencën energjetike, me fokus të veçantë në rritjen e pjesëmarrjes së grave përmes skemave të mbështetjes si bursat. Strategjia synon gjithashtu rritjen progresive të numrit të të diplomuarve dhe profesionistëve të trajnuar në fushat e energjisë, me vlerat fillestare që do të përcaktohen dhe objektivat që do të vendosen gjatë zbatimit.

Agjenda e Reformave të Kosovës (2024–2027)

Është një strategji kombëtare bazë e harmonizuar me Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje. Agjenda përcakton reforma në pesë fusha strategjike për të përshpejtuar konvergjencën ekonomike të Kosovës me BE-në, për të forcuar kapacitetet institucionale dhe për të siguruar qasje në fondet e para-anëtarësimin. E zbatuar gjatë periudhës 2024–2027, apërfshin 111 hapa reformues me piketa cilësore dhe sasore të lidhura me disbursimet e BE-së. ARr trajtohet në kuadër të Zhvillimit dhe Mbajtjes së Kapitalit Njerëzor, me reforma që synojnë përputhjen e arsimit me nevojat e tregut të punës, përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore dhe promovimin e punësimit të të rinjve si elemente kyçe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Masat përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe grupeve të cënueshme në tregun e punës duke orientuar 50% të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP) drejt tyre, si dhe rishikimin e kornizës ligjore për AAP-në dhe ARr për të përmirësuar qeverisjen, si dhe financimin dhe të mësuarit në vendin e punës. Deri në vitin 2026, pritet që të paktën 30% e mësimdhënësve të AAP-së dhe ARr-së të trajnohen në kurrikula të reja, 50% e kualifikimeve joformale të regjistronen në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe gjysma e nxënësve të AAP-së të përfshihen në mësimin në vendin e punës. Deri në vitin 2027, 90% e kualifikimeve formale duhet të regjistronen në KKK dhe 80% e institucioneve të AAP-së të ofrojnë shërbime këshillimi dhe orientimi në karrierë.

Korniza Ligjore

Përmbledhje e kornizës ligjore relevante

ARr në Kosovë rregullohet kryesisht nga Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve (2013). Ligji e pozicionon ofrimin kryesisht brenda sistemit të AAP-së dhe sektorit publik, ndërsa ofrimi joformal, privat dhe ai nga shoqëria civile merr vëmendje të kufizuar. Për më tepër, ARr zbatohet përmes dispozitave të shpërndara në ligje të tjera që lidhen me arsimin, kualifikimet dhe punësimin. Këto përfshijnë, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, që përcakton bazën ligjore për rikthimin e të rriturve në arsimin formal në nivelet e Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (SNKA) 3–4;

Ligjin për AAP-në, që integron ARr në kornizën e aftësive dhe tregut të punës; Ligji për Kualifikimet Kombëtare lidh ARr me standardet, akreditimin dhe NJMP: Ligjin për Agjencinë e Punësimit, që rregullon shërbimet e trajnimit dhe ri-kualifikimit; dhe Ligjin për Arsimin në Komuna, që përcakton përgjegjësitë lokale për ofrimin e shërbimeve.

Ligji nr. 04/L-032 – 2011 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës

Ligji rregullon nivelet SNKA 0–4, duke ndarë përgjegjësitë ndërmjet nivelit qendror, komunal dhe shkollor. Ligji përfshin shprehimisht pjesëmarrësit e rritur që synojnë kualifikime në këto nivele, dhe ofron bazën ligjore për arsimin kompensues në arsimin e mesëm të lartë (SNKA 3–4), duke u mundësuar personave mbi moshën 15 vjeç të rikthehen në arsim përmes programeve të përshtatura. Neni 12 e përcakton ARr si pjesë të të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke garantuar qasje në arsimin profesional dhe ARr, ndërkohë që detajet lidhur me kurrikulën, vlerësimin, tarifat dhe licencimin e ofruesve i lihen legjislacionit dytësor. Kjo krijon një pikë hyrëse ligjore për ARr, të cilin ligji e trajton kryesisht si arsim kompensues dhe profesional, duke anashkaluar dimensionet më të gjera të mësimit gjatë gjithë jetës, si zhvillimi qytetar, kulturor dhe social, në përputhje me qasjet e kornizave të Cedefop-it dhe të BE-së.

Ligji nr. 04/L-143 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve në Republikën e Kosovës

Ligji përcakton kornizën ligjore dhe institucionale për ofrimin e mundësive të të mësuarit për të gjithë individët e moshës 15 vjeç e lart. Mësimi gjatë gjithë jetës përkufizohet si aktivitete që zhvillohen gjatë gjithë jetës për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kualifikimeve. Megjithatë ky përkufizim është i afërt me përdorimin ndërkombëtar, ai e kufizon të mësuarit gjatë gjithë jetës kryesisht në aspektin e punësimit dhe kualifikimeve, duke mos përfshirë plotësisht qasjen më të gjerë të CEDEFOP-it, e cila përfshin edhe zhvillimin personal, qytetar dhe social (Danuza et al., 2021). Njeh formalisht arsimin formal, joformal dhe informal, duke e pozicionuar ARr si pjesë integrale të sistemit të arsimit dhe aftësimit. Megjithatë, përkufizimet janë të shkurtra, gjë që krijon paqartësi. Arsimi formal i të rriturve trajtohet kryesisht si arsim kompensues në nivelet SNKA 2–4, ndërsa dy përkufizime të mbivendosura për arsimin joformal krijojnë konfuzion shtesë. Ndryshe nga përkufizimi i vetëm dhe i unifikuar i të nxënit joformal nga Cedefop, i cili e përcakton atë si të nxënë të planifikuar dhe të qëllimshëm jashtë sistemeve formale që ndonjëherë çon në kualifikime, ligji bën një ndarje ndërmjet një kategorie të gjerë të “arsimit joformal” dhe “arsimit dhe aftësimit joformal”, një dallim që nuk është as standard dhe as konceptualisht i qartë. Në praktikë, ofrimi joformal realizohet kryesisht përmes Qendrave të Aftësimit Profesional (QAP) dhe ofruesve të akredituar, me fokus në ri-kualifikim dhe qasje në tregun e punës (Danuza et al., 2021). Edhe pse certifikatat mund të njihen në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), programet vazhdojnë të klasifikohen si joformale. Të nxënit informal përkufizohet në përputhje me Cedefop si të nxënë i pastrukturuar që ndodh në jetën e përditshme.

Ligji rregullon një gamë të gjerë elementesh, përfshirë fushëveprimin dhe përgjegjësitë e ARr, kategoritë e ofruesve, regjistrimin e pjesëmarrësve, zhvillimin e programeve, procedurat e vlerësimit dhe certifikimit, mekanizmat e sigurimit të cilësisë, NJMP-në, marrëveshjet e qeverisjes dhe modalitetet e financimit.

Arsimi dhe aftësimi i të rriturve është i hapur për një gamë të gjerë ofruesish, përfshirë institucionet publike, partneritetet publike–private, ndërmarrjet, shoqatat profesionale, OJQ-të dhe madje edhe individët. Megjithatë, përgjegjësitë dhe kërkesat rregullative ndryshojnë. Bëhet një dallim i fortë ndërmjet ofrimit formal dhe atij joformal apo informal sa i përket sigurimit të cilësisë. Ofruesit e arsimit formal të të rriturve duhet të licencohen nga MASHTI, ndërsa ofruesit joformalë që ofrojnë kualifikime të lidhura me KKK-në duhet fillimisht të sigurojnë akreditim nga AKK përpara se të marrin licencën nga MASHTI.

Sa i përket financimit, ligji përcakton se sektori publik është përgjegjës për të siguruar qasje në arsimin kompensues për të rritur në nivelet SNKA 1–2, i cili ofrohet pa pagesë. Kjo u mundëson individëve që nuk e kanë përfunduar arsimin bazë gjatë rinisë së tyre të riintegrohen në sistemin arsimor. Ofrim tjetër i ARr, veçanërisht arsimit joformal, mbetet kryesisht i varur nga financimi i donatorëve, kontributet private ose investimet e punëdhënësve. Ligji është planifikuar të rishikohet në vitin 2026 si pjesë e agjendës legjislative të MASHTI-it.

Ligji nr. 03/L-060 – 2008 mbi Kualifikimet Kombëtare

Ligji përcakton strukturën dhe qeverisjen e KKK. AKK është përgjegjëse për AAP-në dhe ARr përmes validimit të kualifikimeve, akreditimit të ofruesve dhe sigurimit të cilësisë së certifikimit. Objektivat përfshijnë njohjen e kualifikimeve nga arsimi formal dhe joformal, përputhjen me nevojat e tregut të punës dhe fleksibilitetin përmes NJMP-së. Nga perspektiva e ARr, ligji ofron pika të rëndësishme hyrëse, veçanërisht përmes njohjes së të mësuarit joformal dhe informal

Ligji nr. 04/L-138 – 2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Ligji përcakton parimet e sektorit të AAP-së në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e tregut të punës, gjithëpërfshirjen dhe integrimin e AAP-së në arsimin gjatë gjithë jetës. Nga perspektiva e ARr, ligji mbështet qasjen në AAP pavarësisht moshës, krijon bazën për programe fleksibile dhe modulare, si dhe përforcon rolin e NJMP në mbështetje të avancimit dhe rikualifikimit të aftësive. Megjithatë, bazuar në gjetjet e vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (2011–2016), ligji duhet të ndryshuar për të siguruar rregullim më efikas të një sërë fushash, duke përfshirë kornizën e kurrikulës së AAP-së, autonominë financiare të shkollave të AAP-së, praktikën profesionale, trajnimin e mësimdhënësve, etj.⁶ Me rendësi, ligji është në proces rishikimi në kuadër të planifikimit ligjor të MASHTI-t, duke ofruar mundësi për zgjerimin e fushëveprimit dhe fuqizimin e rolit të ARr.

Ligji nr. 03/L-018 – 2015 për Provimin Final dhe Provimin e Maturës Shtetërore

Ligji përcakton objektivat, strukturën dhe procedurat e provimit kombëtar që zhvillohet në fund të arsimit të mesëm të lartë në drejtimet e përgjithshme dhe profesionale. Ligji garanton që kandidatët nga programet e ARr kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit në kushte të barabarta. Kërkohet një minimum prej 40% për të kaluar, duke i mundësuar kandidatëve të suksesshëm qoftë të rinj apo të rritur të vazhdojnë në arsimin e lartë.

Ligji nr. 04/L-205 – 2014 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

Ligji themelon Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) nën Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), duke përcaktuar mandatin e saj për zbatimin e politikave të punësimit, tregut të punës dhe trajnimit. Nga perspektiva e ARr, ky ligj është i rëndësishëm pasi përcakton shërbime aktive të punësimit, trajnime profesionale dhe mbështetje për punëkërkuesit.

Ligji nr. 03/L-068 – 2008 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës

Ligji u jep komunave përgjegjësi të plotë për menaxhimin e arsimit parauniversitar (SNKA 0–3), përfshirë stafin, infrastrukturën, pranimin dhe administrimin e shkollave. Komunitet, përmes shkollave të AAP-së, mund të ofrojnë programe kompensuese dhe profesionale për të rriturit.

Politikat e Arsimit të të Rriturve

Politika e ARr në Kosovë është e orientuar kryesisht drejt integritit në tregun e punës dhe punësueshmërisë. NJMP mbetet politika kryesore që aktualisht është në zbatim aktiv, kryesisht në kuadër të AAP të vazhdueshëm. Paralelisht, zhvillimi i aftësive të gjelbra po shfaqet si një prioritet i ri politik, i ndërlidhur me tranzicionin energjetik dhe agjendën e qëndrueshmërisë së Kosovës. Ndërkohë, disa politika tjera relevante për ARr-në, si aftësitë digjitale dhe MVP, mbeten të kufizuara ose janë kryesisht të përqendruara në AAP fillestare. Megjithatë, ekziston një potencial në rritje për të zgjeruar iniciativat e MVP-së dhe të shkathtësive digjitale edhe për të rriturit në të ardhmen, ndërsa kapacitetet institucionale dhe kornizat politike vazhdojnë të zhvillohen.

⁶ Në vitin 2026, drafti i një Ligji të ri për AAP ishte në shqyrtim.

Njohja e Mësimit Paraprak

NJMP në Kosovë rregullohet përmes Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 31/2014 për Njohjen e Mësimit Paraprak dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 09/2019 për kriteret dhe procedurat e akreditimit të institucioneve që zbatojnë NJMP. Qëllimi i NJMP-së në KOSOVË është validimi i të nxënësve joformal dhe informal, në mënyrë që të rriturit të mund të rikthehen në arsim, të fitojnë kualifikime ose të përmirësojnë punësueshmërinë e tyre. NJMP është i lidhur me KKK, ku rezultatet e të nxënësve shërbejnë si pikë reference. Megjithatë ekzistojnë politika udhëzuese për arsimin e lartë dhe AAP-në, zbatimi deri më tani është kufizuar në AAP-në e vazhdueshme (trajnimin e të rriturve) përmes legjislacionit sekondar. Procesi përbëhet nga katër faza: identifikimi, dokumentimi, vlerësimi dhe certifikimi i rezultateve të të nxënësve dhe mund të ofrohet vetëm nga institucione të akredituara nga AKK. Aktualisht, tre (3) ofrues janë të akredituar për zbatimin e NJMP-së, ndërsa tetë (8) të tjerë janë në proces akreditimi, të mbështetur nga 239 praktikues të trajnuar. Në këtë drejtim, projekti i LuxDev Aftësi për punë të qëndrueshme në Kosovë po mbështet zhvillimin e një strategjie për NJMP-në, me synim përmirësimin e shtrirjes dhe shërbimeve informuese për përfituesit potencialë. Për më tepër, projekti mbështet AKK-në në kalimin nga ofrimi tradicional (fizik) i shërbimeve drejt një platforme elektronike më të lehtë për përdorim. Kjo do të mundësojë ofrimin digjital të shërbimeve kryesore të AKK-së dhe do të përmirësojë qasjen për përdoruesit.

Aftësitë e Gjelbra

Zhvillimi i aftësive të gjelbra po bëhet një komponentë gjithnjë e më e rëndësishme e zbatimit të politikave të ARr-së dhe AAP-së në Kosovë, veçanërisht në fushën e energjisë së ripërtëritshme. Projekti i LuxDev Aftësi për punë të qëndrueshme në Kosovë, në bashkëpunim me APRK, mbështet zbatimin e trajnimeve për aftësi të gjelbra për pjesëmarrësit e rritur përmes zhvillimit të materialeve trajnuese dhe sigurimit të pajisjeve, ku Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) kontribuon pjesërisht në komponentin e pajisjeve. Në të njëjtën kohë, Projekti për Përsheptimin e Tranzicionit të Drejtë dhe të Barabartë (JETA), që zbatohet në kuadër të Marrëveshjes me Millennium Challenge Corporation (MCC) përmes Millennium Challenge Account – Kosovo (MCA-KS), po kontribuon në avancimin e zbatimit të politikave përmes themelimit të një qendre trajnime në kuadër të University of Prishtina dhe zhvillimit të programeve të reja të trajnimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme për të rriturit, pos ndërhyrjeve tjera. Këto iniciativa, të marra së bashku, pasqyrojnë një përkushtim të qartë politik për integrimin e zhvillimit të shkathtësive të gjelbra në sistemet e ARr dhe të AAP-së në Kosovë, me synim pajisjen e fuqisë punëtore me kompetencat e nevojshme për tranzicionin e gjelbër.

Performanca kombëtare kundrejt objektivave kyçe të BE-së për Arsimin e të Rriturve

Ky seksion do të krahasojë të dhënat aktuale mbi pjesëmarrjen e të rriturve në të mësuar në nivel kombëtar me të dhënat në nivel të BE-së, duke marrë në konsideratë objektivat referente të mëposhtme të përcaktuara nga BE-ja.

Pjesëmarrja e të rriturve në të mësuar

Objektivat e BE-së	Objektivat Kombëtare
Të paktën 47% e të rriturve të moshës 25–64 vjeç të kenë marrë pjesë në të mësuar gjatë 12 muajve të fundit, deri në vitin 2025.	Shkalla mesatare e pjesëmarrjes së të rriturve (25–64 vjeç) në të mësuar ishte 11.5% gjatë periudhës 2020–2023, pak mbi mesataren e BE-së prej 11.2% (OECD, 2025) ⁷ .

⁷ Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës të dorëzuara në OECD.

Objektivat e BE-së	Objektivat Kombëtare
	14% e të rriturve (18–65 vjeç) kanë marrë pjesë në arsim formal gjatë vitit të kaluar dhe rreth 13% në arsim joformal/informal (DVV International, DIE & Riinvest Institute, 2020). ⁸ 5.6% e të rriturve (25–65 vjeç) kanë marrë pjesë në të nxënë, në vitin 2020 (ETF, 2021). ⁹
Të paktën 60% e të rriturve të moshës 25–64 vjeç të kenë marrë pjesë në të mësuar gjatë 12 muajve të fundit, deri në vitin 2030.	Rritja e pjesëmarrjes së të rriturve të moshës 25–64 vjeç në trajnim me 10% deri në vitin 2027, duke u nisur nga një bazë prej 2.7% në vitin 2019 (Strategjia e Punësimit 2024–2028, 2024). Rritja e pjesëmarrjes në arsimin e të rriturve është përcaktuar si fushë rezultati/ndikimi, por pa një objektiv të qartë numerik (Strategjia e Arsimit 2022–2026, 2022)

Burimi i tabelës: Autori

Strategjia e Punësimit 2024–2028, e miratuar në vitin 2024, përcakton një objektiv për rritjen e pjesëmarrjes me 10% deri në vitin 2027. Megjithatë, ky objektiv bazohet në një nivel fillestar të papërditësuar prej 2.7%, vlerësuar fillimisht në vitin 2019. Si rrjedhojë, objektiva kombëtare mbetet relativisht e ulët dhe nuk reflekton progresin më të fundit, e as nuk është e përafëruar me standardet evropiane. Sipas OECD (2025), pjesëmarrja e të rriturve në të nxënë ka arritur mesatarisht 11.5% gjatë periudhës 2020–2023, pak mbi mesataren e BE-së prej 11.2%, ndërsa ETF (2021) raporton një normë më të ulët prej 5.6% për vitin 2020. Këto dallime shpjegohen me qasje të ndryshme metodologjike. OECD përdor mesatare shumëvjeçare (2020–2023), ndërsa ETF bazohet në një vlerësim njëvjeçar (2020). Në të njëjtën kohë, studimi i DVV International, DIE & Riinvest (2020) paraqet nivele edhe më të larta të pjesëmarrjes (14% në arsimin formal dhe 13% në atë jopërformal) për grupmoshën 18–65 vjeç, duke përdorur një përkufizim më të gjerë të të mësuarit dhe një periudhë referimi prej 12 muajsh. Këto dallime tregojnë për mospërputhje metodologjike ndërmjet burimeve dhe nënvizojnë nevojën për harmonizim dhe përditësim të rregullt të të dhënave, në mënyrë që raportimi i treguesve të ARr të jetë i krahasueshëm dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Nivelet e nën-arritjes në aftësitë bazë dhe digjitale, si dhe performanca e lartë në aftësitë bazë

Objekti i BE-së	Gjendja aktuale në Kosovë
Pjesa e nën-arritjes në lexim, matematikë, shkencë dhe aftësi digjitale duhet të jetë më e ulët se 15%, ndërsa pjesa e performancës së lartë në lexim, matematikë dhe shkencë duhet të jetë së paku 15% deri në vitin 2030	Në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) 2022, vetëm 15% e nxënësve arritën nivelin 2+ në matematikë, 17% në lexim dhe 21% në shkencë, çka nënkupton se afërsisht 85%, 83% dhe 79% e nxënësve përkatësisht ishin nën nivelin bazë në këto fusha. Nuk u identifikuan pothuajse fare nxënës me performancë të lartë në matematikë (PISA, 2022). Sa i përket aftësive digjitale, Kosova mori pjesë në studimin ICILS 2023, por të dhënat specifike për vendin mbi përqindjen e nxënësve me kompetenca të mjaftueshme nuk janë publikuar ende. Krahasimet ndërkombëtare e pozicionojnë vendin në pjesën e poshtme të renditjes, duke sugjeruar se përqindja e nxënësve nën nivelin 2 është dukshëm mbi objektivin prej 15% (publikimi ndërkombëtar i ICILS, 2022). Në vitin 2023, vetëm 25.4% e të rriturve në Kosovë zotëronin aftësi digjitale bazë ose më të avancuara. dukshëm më pak se mesatarja e BE-së prej 55.6% dhe mesatarja rajonale prej 33.85% (OECD, 2025)

Burimi i tabelës: Autori

Kosova ende nuk ka përcaktuar objektiva kombëtare apo mekanizma monitorimi që përputhen në mënyrë specifike me treguesit e PISA-s për të ulur nën-arritjen dhe për të përmirësuar performancën e

⁸ Anketa për ARr në Kosovë, e zbatuar nga Instituti Riinvest në vitin 2020 me mbështetjen e DVV International dhe DIE, përdori një kampion përfaqësues në nivel kombëtar prej rreth 2,400 të rriturish të moshës 18–65 vjeç. Të dhënat u mblodhën përmes intervistave ballë për ballë (CAPI) gjatë periudhës tetor–dhjetor 2020. Ankesa matin pjesëmarrjen e të rriturve në të nxënë gjatë 12 muajve të mëparshëm, duke përfshirë arsimin formal (që çon në kualifikime të njohura), arsimin joformal (veprimtari mësimore të strukturuar jashtë sistemit formal) dhe atë informal.

⁹ Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore për vitin 2020, të ofruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

lartë në lexim, matematikë, shkencë dhe aftësi digjitale. Strategjitë aktuale arsimore theksojnë përmirësimin e përgjithshëm dhe sigurimin e cilësisë, por nuk janë përcaktuar objektiva të qarta dhe të matshme të harmonizuara me PISA-n.

STEM në AAP

Objektivi i BE-së	Gjendja aktuale në Kosovë
Pjesa e nxënësve të regjistruar në fushat STEM në arsimin dhe aftësimin profesional fillestar të nivelit të mesëm duhet të jetë së paku 45%, ndërsa të paktën 1 në 4 nxënës duhet të jenë femra deri në vitin 2030.	Gjatë vitit shkollor 2024/25, 40.7% e nxënësve në arsimin dhe aftësimin profesional fillestar ishin të regjistruar në fusha STEM (14 202 nga 34 929) në klasat 10, 11 dhe 12, të shpërndarë në 56 profile. Nxënëset përbënin 19.7% (2 793) të regjistrimeve në STEM, ose afërsisht një në pesë nxënës në këto fusha.

Burimi i tabelës: Autori

Kosova ka shënuar progres pozitiv në pjesëmarrjen e përgjithshme në fushat STEM; megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur përfaqësimin e grave në AAP, me qëllim arritjen e objektivave të vitit 2030.

STEM në arsimin e lartë

Objektivi i BE-së	Gjendja aktuale në Kosovë
Pjesa e studentëve të regjistruar në fushat STEM në arsimin e lartë duhet të jetë së paku 32%, ndërsa të paktën 2 nga 5 studentë duhet të jenë femra deri në vitin 2030.	Në vitin akademik 2023/24, 27.9% e studentëve në nivel Bachelor janë të regjistruar në fushat STEM (17,071 nga 61,253). Gratë përbëjnë 44.8% të studentëve STEM në nivel Bachelor (7,654 nga 17,071), që korrespondon me rreth 1 grua për çdo 1.2 burra (ASK, 2025). Në nivelin master, 24.2% e studentëve të regjistruar për herë të parë ishin në fusha STEM (937 nga 3 866), ku gratë përbënin 50.4% (472 nga 937), duke reflektuar një përfaqësim pothuajse të barabartë ndërmjet grave dhe burrave.

Burimi i tabelës: Autori

Kosova mbetet nën objektivin e BE-së për vitin 2030 prej 32% të regjistrimeve në fushat STEM në arsimin e lartë: 27.9% e studentëve në nivelin bachelor dhe 24.2% e studentëve të regjistruar në nivelin pasuniversitar ishin të përfshirë në fusha STEM në vitin akademik 2023/24. Megjithatë, shpërndarja gjinore është relativisht e favorshme: gratë përbënin 44.8% të regjistrimeve në nivelin bachelor në STEM dhe 50.4% të studentëve të rinj në nivelin master. Kjo tregon se, në Kosovë, hendeuku kryesor qëndron tek niveli i përgjithshëm i pjesëmarrjes në STEM, më shumë sesa tek balanca gjinore.

Programet e doktoratës në fushën e TIK-ut

Objektivi i BE-së	Gjendja aktuale në Kosovë
Pjesa e studentëve të regjistruar në programe doktoratë në TIK duhet të jetë së paku 5%, ndërsa të paktën 1 në 3 studentë duhet të jenë femra deri në vitin 2030.	Numri i studentëve të regjistruar në programe doktoratë në TIK gjatë vitit akademik 2023/24 përbën 22.7% të të gjithë studentëve të doktoratës (10 nga 44 studentë PhD) (MASHTI, 2025). Megjithatë, gratë përbëjnë 30.0% të studentëve të pranuar në doktoratë në TIK (tre nga dhjetë).

Burimi i tabelës: Autori

Kosova e tejkalon objektivin e Unionit të Shkathtësive 2030 për regjistrimet në doktoratë në TIK, me 22.7% të studentëve PhD të regjistruar në TIK gjatë vitit akademik 2023/24, dukshëm mbi pragun prej 5%. Pjesëmarrja e grave, me 30.0%, mbetet pak nën objektivin prej një në tre. Kjo tregon se, megjithëse regjistrimi në fushën e TIK-ut është i lartë në nivel doktorate, balanca gjinore mbetet paksa nën objektivin e vitit 2030.

Përfundime

Pikat e forta

- Fokusi në punësueshmëri, kompetenca digjitale dhe përfshirjen e grupeve të cënueshme është në përputhje me prioritetet e BE-së për zhvillimin e aftësive dhe kohezionin social.
- Korniza ligjore përfshin arsimin formal, joformal dhe informal, si dhe NJMP duke zgjeruar mundësitë për përmirësimin e aftësive të të rriturve, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe rikthimin në arsim.
- Integrimi i NJMP-së në KKK, mbështetur nga aktet nënligjore dhe akreditimi i ofruesve, u ofron të rriturve rrugë alternative drejt kualifikimeve dhe avancimit në karrierë, në përputhje me parimet e BE-së për validimin e të nxënës joformal dhe informal.
- Rishikimi afatmesëm i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2022–2026 tregon arritje konkrete, përfshirë themelimin e Qendrave për ARr, zhvillimin e kurrikulave të reja, zgjerimin e institucioneve që zbatojnë NJMP dhe ofrimin e subvencioneve për kandidatët e marginalizuar.
- Strategjitë kombëtare përfshirë Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2030 dhe Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2022–2026, përcaktojnë objektiva të matshme për trajnimin e mësimeve, aftësitë digjitale, pjesëmarrjen dhe punësueshmërinë, duke reflektuar përafrim me prioritetet e BE-së.
- Hapat fillestarë drejt zhvillimit të politikave për aftësi të gjelbra janë ndërmarrë, me LuxDev dhe JETA (MCC/MCA-K) që mbështesin trajnime në fushën e energjisë së ripërtëritshme, duke lidhur ARr me agjendën e tranzicionit të gjelbër.

Sfidat

- Sektori i ARr është i fragmentuar, me politika të shpërndara nëpër strategji të ndryshme dhe pa një vizion të unifikuar apo një strategji të dedikuar kombëtare për ARr.
- Korniza ligjore thekson kryesisht AAP-në dhe arsimin kompensues, ndërsa dimensionet më të gjera të të nxënës gjatë gjithë jetës (qytetare, sociale dhe kulturore) mbeten të paadresuara në legjislacion.
- Financimi për objektivat e ARr është i pamjaftueshëm, me pjesën më të madhe të burimeve që varen nga donatorët e jashtëm.
- Normat e pjesëmarrjes në ARr dhe në zhvillimin e aftësive digjitale mbeten dukshëm nën objektivat e BE-së, veçanërisht për gratë, popullsinë rurale dhe komunitetet pakicë, pavarësisht masave të synuara të ndërgjegjësimi.
- Objektivat kombëtare të pjesëmarrjes (p.sh. rritje prej 10% deri në vitin 2027) bazohen në të dhëna fillestare të pa përditësuara dhe mbeten nën standardet e BE-së.
- Paqartësitë dhe mbivendosjet në përkufizimin e arsimit jopërfshirë krijojnë paqartësi në zbatim, duke kufizuar zhvillimin dhe zgjerimin e rrugëve të ndryshme të ARr.
- Vendi ende nuk ka vendosur objektiva kombëtare dhe mekanizma monitorimi që përputhen me objektivat e PISA-s dhe disa tregues të tjerë të Unionit të Shkathtësive.

Gjendja aktuale

- ARr në Kosovë trajtohet në mënyrë ndërsektoriale, duke u integruar në strategjitë kombëtare për arsim, punësim, digjitalizim dhe përfshirje sociale, dhe jo përmes një strategjie të veçantë. Prioritetet kryesore përfshijnë përmirësimin e punësueshmërisë së të rriturve dhe kompetencave digjitale, rritjen e pjesëmarrjes në të mësuarit gjatë gjithë jetës, NJMP si dhe promovimin e përfshirjes së grupeve të cënueshme.
- Korniza ligjore **është pjesërisht e harmonizuar** me strategjitë kombëtare. Ndërkohë që mundëson rrugë të të mësuarit formal, joformal dhe informal, fokusi mbetet kryesisht në arsimin profesional dhe atë kompensues. Si rrjedhojë, objektivat më të gjera të të mësuarit gjatë gjithë jetës, si ato që lidhen me dimensionet qytetare, sociale apo kulturore, mbeten të nën-përfaqësuar.
- Ekzistojnë mbivendosje dhe mospërputhje ndërmjet ligjeve dhe strategjive, veçanërisht në fushën e arsimit joformal. Përdorimi i strategjitë theksojnë zgjerimin dhe gjithëpërfshirjen, dispozitat ligjore mbeten të limituara, duke rezultuar në **mospërputhje të pjesshme**.

- Politikat për ARr në Kosovë **janë të fragmentuara**. Përgjegjësitë dhe politikat janë të shpërndara ndërmjet disa ministrive dhe strategjive sektoriale, në vend që të jenë të unifikuara në një kornizë të vetme. Kjo rezulton në mbivendosje mandatesh, zbatim jo të njëtrajtshëm, përkufizime të ndryshme (veçanërisht sa i përket të mësuarit joformal), si dhe boshllëqe në të dhëna dhe koordinim, ndërkohë që sektori mbetet i varur në masë të madhe nga projektet e donatorëve.
- Kosova e monitoron arsimin e të rriturve përmes treguesve si shkalla e pjesëmarrjes, arritja e aftësive digjitale, zhvillimi i mësimdhënësve dhe programeve, si dhe rezultatet në punësim.
- Treguesit e krahasimit dhe objektivat kombëtare janë vetëm pjesërisht të përafëruara me objektivat dhe treguesit përkatës të politikave të BE-së.

KAPITULLI II: RREGULLIMET INSTITUCIONALE DHE QEVERISJA NË ARSIMIN E TË TË RRITURVE


Ky kapitull analizon dhe paraqet ndarjen e roleve dhe përgjegjësi ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe karakteristikat kryesore të modelit të qeverisjes që zbatohet për nën-sektorin e ARr.

Rregullimet institucionale

ARr në Kosovë organizohet brenda një kornize ligjore të decentralizuar. Megjithatë, në një masë të caktuar, funksionon në mënyrë të centralizuar. Sistemi karakterizohet nga një diversitet i lartë i palëve të interesit, përfshirë: agjenci si AKK dhe AAPARr, Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (KAAPARr), komunitat, partnerët socialë, OJQ, si dhe donatorët ndërkombëtarë.

Rolet dhe përgjegjësitë në ARr

Diagrami më poshtë ofron një pasqyrë të përgjegjësi të secilit institucion të përfshirë, ashtu siç përcaktohen nga korniza ligjore në fuqi. Një përmbledhje e detajuar e institucioneve dhe përgjegjësi të tyre është përfshirë në [Shtojcën IV](#).



*Monitorimi dhe Evaluimi

Këshillat sektorialë të aftësive vazhdojnë të funksionojnë kryesisht në bazë projektesh dhe ende nuk janë të institucionalizuara në legjislacion, ndonëse formalizimi i tyre është në shqyrtim në kuadër të legjislacionit për AAP. Edhe pse përgjegjësitë janë të përcaktuara formalisht, mbivendosjet në qeverisjen e ARr vazhdojnë të jenë të pranishme. Këshilli Ekonomik Social (KES) ka marrë një rol ekzekutiv në miratimin e ndryshimeve në Librin e Klasifikimit të Profesioneve, i cili është hartuar dhe po zbatohet nga APRK në përputhje me mandatin e saj, duke krijuar paqartësi në përgjegjësi. Ngjashëm, AAPARr zhvillon kurrikula për Qendrat e Kompetencës (QK), ndërsa MASHTI mbikëqyr kurrikulat e shkollave të AAP-së. Si rrjedhojë, funksionet mbivendosen, duke rezultuar në një qeverisje të fragmentuar. Si MASHTI ashtu edhe APRK fokusohen kryesisht në ofruesit publikë, me përfshirje të kufizuar të akterëve privatë ose të organizatave joqeveritare, ndërsa këshillat sektorialë mbeten të bazuar në projekte në pritje të rishikimeve ligjore. Përgjegjësitë për Monitorimin dhe Vlerësimin në sistemin e arsimit dhe aftësimit në Kosovë ndahen ndërmjet MASHTI-t, AKK dhe

Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. MASHTI mbikëqyr zbatimin e politikave dhe performancën e sistemit në nivel strategjik; AKK monitoron sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërinë e kualifikimeve dhe ofruesve brenda KKK; ndërsa Inspektorati Shtetëror i Arsimit vlerëson performancën institucionale dhe respektimin e standardeve arsimore përmes inspektimeve të rregullta.

Modeli i qeverisjes së Arsimit të të Rriturve

Megjithëse qeverisja e arsimit të të rriturve në Kosovë është formalisht e decentralizuar, në praktikë ajo mbetet në një masë të caktuar e centralizuar. MASHTI është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, monitorimin, rregullimin, sigurimin e cilësisë. Ushtron edhe disa funksione ekzekutive lidhur me ofrimin. APRK luan rol operacional në koordinimin dhe zbatimin e Masave Aktive të Tregut të Punës (ALMM), veçanërisht përmes QAP-ve, ndërsa AAPAR menaxhon QK.

Përgjegjësitë operationale janë transferuar me ligj tek komunat; megjithatë, Diagnostikimi i Shpejtë i Arsimit në Kosovë thekson se MASHTI vazhdon të ndërhyjë në zbatim, ndërsa Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) përballen me kufizime në burime dhe me kapacitete të kufizuara për të përmbushur funksionet e tyre (ETF, 2023). Shkollat e AAP-së dhe QAP-të gëzojnë autonomi të kufizuar, pasi vendimmarrja operationale dhe financiare mbetet kryesisht e ndikuar nga niveli lokal dhe/ose qendror.

AKK menaxhon KKK, e cila përfshin të gjitha format e të nxënësve dhe kualifikimeve, përfshirë mësimin gjatë gjithë jetës, dhe është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve dhe ofruesve të ARr.

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërsektorial

Në Kosovë, pjesëmarrja e palëve të interesit në qeverisjen e ARr është paraparë, por në praktikë përballen me kufizime të konsiderueshme. Trupat këshillëdhënëse janë reduktuar ose janë jofunksionale. AAPAR, APRK dhe QAP-at nuk kanë më struktura drejtuese (vendimmarrëse), KES është joaktiv, ndërsa KAAPARr funksionon me vështirësi. Palët e interesit konsultohen kryesisht gjatë hartimit të strategjive dhe legjislacionit, siç kërkohet nga Rregullorja nr. 13/2013, por roli i tyre në planifikim, zbatim dhe monitorim mbetet i dobët. Për më tepër, OJQ-të janë të përjashtuara nga strukturat formale. MVP ka mundur një përfshirje më të madhe të Odës Ekonomike të Kosovës, e cila ka marrë një rol në koordinimin dhe mbështetjen e MVP/Mësimin dual. Bashkëpunimi ndërsektorial përfshin shumë akterë, por mbetet i fragmentuar dhe kryesisht i nxitur nga donatorët. Rrjeti për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve në Kosovë (RrAAPK) është një iniciativë e re joformale që synon të shërbejë si platformë koordinuese, duke bashkuar ministri, agjenci, komuna, OJQ, ofrues dhe donatorë për të promovuar dialogun, avokimin dhe nisma të përbashkëta. Nisma RrAAPK ka potencial të lartë dhe meriton mbështetje të vazhdueshme për t'u konsoliduar si një platformë e besueshme dhe për të kaluar përtej fazës fillestare. Në përgjithësi, bashkëpunimi mbetet i mbështetur nga projektet dhe nga partnerë ndërkombëtarë, më shumë sesa i integruar në mekanizma të përhershëm institucionalë.

Përfaqësimi institucional në organet e qeverisjes, drejtimit dhe koordinimit në nën-sektorin e ARr

Në qeverisjen e ARr, organet e drejtimit dhe koordinimit synojnë të garantojnë pjesëmarrjen e palëve të interesit në hartimin dhe zbatimin e politikave. Megjithatë, që nga miratimi i Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore¹⁰ (2019, i ndryshuar), ministritë e linjës i kanë interpretuar agjencitë ekzekutive si organe administrative nën autoritetin e tyre të drejtpërdrejtë, të udhëhequra nga drejtorë, dhe rrjedhimisht pa nevojën për borde vendimmarrëse apo këshillëdhënëse. Si pasojë, këto institucione funksionojnë pa përfaqësim formal të palëve të interesit, duke bërë që partnerët socialë dhe akterë të tjerë të mos përfshihen më në mënyrë sistematike në proceset e zhvillimit të politikave dhe vendimmarrjes në nën-sektorin e ARr.

¹⁰ Ligji nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2706>.

Përfaqësimi institucional në organet e qeverisjes, drejtimit dhe koordinimit për ARr në Kosovë, përfshirë rolet specifike dhe pjesëmarrjen e palëve të ndryshme të interesit, paraqitet në [Shtojcën V](#).

Rrjeti i ofruesve të Arsimit Formal dhe Joformal të të Rriturve

Rrjetet lehtësojnë avokimin, njohjen e sektorit të arsimit të të rriturve dhe ndërtimin e aleancave në të gjithë spektrin e akterëve publikë dhe jopublikë në këtë sektor. Platforma e lartpërmendur RrAAPK është një platformë joformale, shumë-palëshe e themeluar në vitin 2022 me mbështetjen e DVV International. Ajo bashkon institucionet qeveritare (MASHTI, APRK, AAPARr), organizatat joqeveritare, ofruesit e trajnimeve, Institutin Pedagogjik dhe partnerët ndërkombëtarë me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe njohjes së ARr. Veprimtaria e RrAAPK është përqendruar në avokim, rritje të ndërgjegjësimit dhe përafrim me prioritetet e BE-së për mësimin gjatë gjithë jetës. Aktualisht, po shqyrtohen hapa për formalizimin e rrjetit dhe forcimin e qëndrueshmërisë dhe ndikimit të RrAAPK në politika.

Gjithashtu, Platforma Elektronike për Arsimin e të Rriturve në Evropë (EPALE) Kosovë u lansua zyrtarisht në maj 2025, duke e lidhur më tej vendin me platformën evropiane për ARr dhe duke zgjeruar mundësitë për shkëmbim përvojash, ndarje të praktikave të mira dhe qasje në burime në nivel të BE-së.

Financimi i Arsimit të të Rriturve

ARr në Kosovë financohet nga burimet e mëposhtme:

1. Fondet Publike

Arsimi kompensues (nivelet SNKA 1–2) dhe trajnimet për punëkërkesit në QAP ofrohen pa pagesë dhe financohen nga buxheti publik. Ofrimi falas zbatohet gjithashtu për nxënësit në AAP të nivelit të mesëm të lartë që janë përfitues të skemave sociale, fëmijët e veteranëve të luftës dhe personat me aftësi të kufizuara. Trajnimet për avancim dhe rikualifikim ofrohen gjithashtu pa pagesë nga IKAP dhe Akademia e Policisë së Kosovës për punonjësit e tyre.

Financimi i ARr është i integruar në linjat buxhetore të arsimit ose të aftësimin profesional, pa një linjë buxhetore të dedikuar për ARr. Rrjedhimisht, e bën të vështirë përcaktimin e saktë të nivelit të shpenzimeve dhe dhe të peshës së tyre në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).

Sa i përket financimit brenda PSAK-ut, alokimi për ARr për periudhën 2022–2026 përbën vetëm 0.16% të buxhetit total të PSAK-ut (505,920 EUR nga 322.8 milionë EUR). Edhe brenda objektivit specifik për AAP dhe ARr, pjesa e dedikuar për ARr arrin vetëm 2.7% të totalit të këtij objekti (505,920 EUR nga 19 milionë EUR).

Burimet e financimit për ARr nga buxheti i shtetit, si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal, paraqiten në [Shtojcën VI](#).

2. Kontributet e pjesëmarrëseve të rritur

Pjesëmarrësit e rritur shpesh mbulojnë vetë tarifat e pjesëmarrjes në programet e ARr. Në arsimin kompensues të nivelit të mesëm të lartë, pjesëmarrësit duhet të paguajnë tarifa që variojnë nga 100–130 euro në vit, si dhe pagesa shtesë prej 50 euro për praktikën profesionale, 10 euro për provimet diferenciale dhe 30 euro për provimin përfundimtar dhe certifikatën.¹¹

3. Organizatat e Shoqërisë Civile

Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm, duke ofruar shpesh trajnime në fusha si demokratizimi, përfshirja sociale dhe të drejtat e njeriut (Danuza et al., 2021). Këto aktivitete zakonisht

¹¹ [Udhëzimi Administrativ i MASHT nr. 11/2011](#) për pjesëmarrjen e ndjekësve në arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

financohen nga donatorët ose nga fondet publike, duke mundësuar ofrimin e programeve pa pagesë ose me kosto të ulët për pjesëmarrësit.

4. Kontributet e Punëdhënësve dhe Sektorit Privat

Ndërmarrjet, në disa raste, bashkëfinancojnë trajnimet për avancim ose rikualifikim të punonjësve të tyre, megjithëse investimi i sektorit privat mbetet i kufizuar. Zakonisht, këto trajnime ofrohen nga ndërmarrje më të mëdha, kryesisht në sektorët e bankave dhe prodhimit, për stafin e tyre.

5. Mbështetja e Donatorëve

Iniciativat e financuara nga donatorët janë thelbësore për qëndrueshmërinë e ARr, duke mbështetur zhvillimin e kurrikulave, ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve dhe avancimin e pajisjeve (Danuza et al., 2021).

Megjithatë, edhe kur merren së bashku burimet e lartpërmendura, financimi i ARr mbetet i pamjaftueshëm, duke e lënë sektorin të nënfinancuar, me qëndrueshmëri të kufizuar dhe me kapacitete të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve shoqërore.

Monitorimi dhe Sigurimi i Cilësisë

Rolet dhe përgjegjësitë institucionale për sigurimin e cilësisë në ARr në Kosovë janë të shpërndara ndërmjet disa institucioneve kyçe, secili me mandate specifike për monitorim, akreditim, inspektim dhe zhvillim profesional brenda kornizës së sigurimit të cilësisë.

Megjithatë, sistemi nuk disponon një kornizë gjithëpërfshirëse të sigurimit të cilësisë për ARr. Monitorimi i rezultateve është i kufizuar dhe i fragmentuar, duke mbuluar kryesisht programet formale të ofruara nga ofruesit publikë (p.sh. QAP-at) dhe ofruesve të akredituar nga AKK. Programet e ofruara nga sektori privat dhe OJQ-të mbeten kryesisht jashtë vlerësimit sistematik.

Sistemet ekzistuese të informacionit mbeten të fragmentuara, duke e vështirësuar monitorimin e politikave dhe, rrjedhimisht, hartimin e politikave të bazuara në dëshmi në të gjithë sektorin e ARr. MASHTI mbledh të dhëna përmes SMIA, por vetëm për kandidatët e rritur në shkollat e AAP, duke përjashtuar të rriturit në arsimin kompensues bazik. AKK mbledh të dhëna për kandidatët e regjistruar tek ofrues të akredituar që ofrojnë kualifikime të regjistruara në KKK, ndërsa APRK grumbullon statistika për punëkërkuarit që marrin pjesë në trajnime përmes QAP-ve. Nuk ekzistojnë sisteme të menaxhimit të informatave që të marrin të dhëna për kandidatët e rritur të regjistruar në programe të ofruara nga ofrues privatë ose OJQ që nuk janë të akredituar.

Rolet dhe përgjegjësitë institucionale

Sigurimi i cilësisë në ARr në Kosovë ndahet ndërmjet disa institucioneve, me përgjegjësi të përcaktuara përmes dispozitave ligjore.

MASHTI është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të politikave dhe legjisllacionit për ARr. Po ashtu, MASHTI është përgjegjëse për miratimin e të gjitha programeve të trajnimit në shërbim për mësimdhënësit¹². Vlerëson dhe akrediton programet e trajnimit për të siguruar që ato përmbushin standardet kombëtare dhe treguesit e cilësisë.

Inspektorati i Arsimit është përgjegjës për inspektimet pedagogjike dhe administrative të të gjithë ofruesve të arsimit dhe aftësimin në vend, përfshirë ata që ofrojnë ARr dhe arsimin kompensues. Në praktikë, mbikëqyrja e tij kufizohet kryesisht në shkolla, pasi numri i kufizuar i inspektorëve limiton mbulim më të gjerë.

¹² Udhëzimi Administrativ (UA) 12/2023 (Kriteret për Programet e Zhvillimit Profesional), UA 13/2023 dhe UA 14/2023 (Sistemi i Licencimit të Mësimdhënësve dhe Zhvillimi i Karrierës).

AKK luan një rol qendror si organ rregullator, duke verifikuar Standardet e Profesionit (SP), duke validuar dhe miratuar kualifikimet e ARr për përfshirje në KKK, si dhe duke akredituar ofruesit për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimeve. Akreditimi kërkohet veçmas për secilën formë ofrimi: formën e rregullt (klasike) të trajnimit, MVP dhe NJMP. Vetëm ofruesit e akredituar janë të autorizuar të ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë kualifikime të ARr-së në kuadër të KKK-së dhe të zbatojnë NJMP-në.

Stafi mësimdhënës i programeve të specializuara të arsimit të të rriturve

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZhVP) për mësimdhënësit rregullohet dhe ofrohet përmes programeve të trajnimit në shërbim të miratuara nga MASHTI. Megjithatë, mësimdhënësit për të rritur nuk njihen si një grup i veçantë profesional dhe nuk ekziston një kornizë e posaçme për ZhVP-se e përshtatur për pedagogjinë e të rriturve. Si rrjedhojë, mësimdhënësit dhe trajnerët që punojnë me të rritur mbështeten në të njëjtat mundësi trajnimi si stafi i arsimit të përgjithshëm, të cilat shpesh nuk reflektojnë nevojat specifike të të rriturve. Përderisa, PSAK 2022–2026 thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve njerëzore në ARr dhe AAP, por nuk përcakton standarde të qarta të ZhVP-së për mësimdhënësit dhe trajnerët e të rriturve. Së fundmi, trajnimi Curriculum globALE është akredituar nga MASHTI. Ofrohet nga Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim në Arsim pranë Fakultetit të Edukimit, me mbështetjen e DVV International, dhe siguron program përgatitor të njohur ndërkombëtarisht për edukatorët e të rriturve. Në vitin 2025, dymbëdhjetë pjesëmarrës janë certifikuar si master trajnerë, ndërsa një grup i ri prej 20 pjesëmarrësish, kryesisht nga QK-të, janë certifikuar.

Paralelisht, NJMP ka krijuar një kategori të re të praktikuesve të ARr, përfshirë koordinatore, mentorë dhe vlerësues. AKK ka përcaktuar kriteret për këto role, duke kërkuar trajnim të specializuar mbi rezultatet e të nxënës, metodat e vlerësimit dhe sigurimin e cilësisë. Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga AKK është e detyrueshme, pasi procedurat e akreditimit kërkojnë që institucionet të dëshmojnë se praktikuesit e tyre janë të trajnuar përpara se të mund të zbatojnë NJMP-në. Deri më tani, 239 praktikues të NJMP-së janë trajnuar nga AKK.¹³

Përfundime

Anët e forta

- KKK promovon të gjitha format e të mësuarit, si arsimi formal, joformal dhe informal, si dhe të gjitha llojet e kualifikimeve, përfshirë ato që lidhen me ARr. Qasja falas në arsimin kompensues dhe trajnimet për punëkërkesit në QAP-a krijojnë mundësi për përfshirjen e grupeve të cënueshme.
- Platforma në zhvillim e sipër për bashkëpunim, si RrAAPK, promovojnë dialogun dhe koordinimin ndërmjet institucioneve dhe ofruesve.
- Ngritja e kapaciteteve për mësimdhënësit për të rritur është përmirësuar së fundmi përmes nismave si akreditimi i Curriculum globALE dhe certifikimi i master trajnerëve si dhe trajnimi i mbi 200 praktikuesve të NJMP-së nga AKK.

Sfidat

- Rolet dhe përgjegjësitë në qeverisjen e ARr nuk janë të përcaktuara qartë. Në disa raste, dispozitat ligjore mbivendosen ose janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, duke krijuar paqartësi në llogaridhënie dhe duke dobësuar koherencën e përgjithshme të sistemit.
- KES nuk është funksional, ndërsa institucione si AAPARR, APRK dhe QAP-të nuk kanë më organe drejtuese ose këshillëdhënëse, gjë që kufizon pjesëmarrjen e palëve të interesit.
- Palët e interesit përfshihen në hartimin e politikave, por jo në planifikimin e tyre në rol këshillëdhënës ndaj qeverisë. Roli i tyre në zbatim dhe monitorim mbetet i kufizuar.

¹³ Të dhëna të siguruara nga AKK.

- Sektori i OJQ-ve mbetet i nënpërfaqësuar në strukturat e qeverisjes, duke reduktuar diversitetin e zërave në të mësuarit gjatë jetës.
- NJMP po avancohet ngadalë, me vetëm 3 ofrues të akredituar deri më tani.
- Financimi i ARr është i pamjaftueshëm, pa një linjë buxhetore të dedikuar, me varësi nga projektet e donatorëve dhe pagesat e pjesëmarrësve. Alokimi në kuadër të PSAK-ut është gjithashtu shumë i ulët.
- Ekzistojnë boshllëqe në monitorimin e programeve joformale dhe ofrimit nga OJQ-të, si dhe në sigurimin e standardeve profesionale për trajnerët/facilitatorët.
- Sistemet e monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave ekzistojnë, por janë të fragmentuara dhe të pamjaftueshme, duke vështirësuar planifikimin e bazuar në dëshmi dhe përshtatjen e politikave.

Gjendja aktuale

- Megjithëse ARr në Kosovë është ligjërish i decentralizuar, qeverisja mbetet pjesërisht e centralizuar dhe e përqendruar në nivel qendror, ku MASHTI mban një rol dominues në hartimin dhe zbatimin e politikave. Institucione të tjera kontribuojnë në sigurimin e cilësisë dhe zbatim, por roli i tyre është më pak i theksuar. Partnerët socialë përfshihen kryesisht në hartimin e politikave, ndërsa OJQ-të dhe donatorët angazhohen përmes mekanizmave konsultativë ose të bazuar në projekte. Kjo tregon se decentralizimi ende nuk është reflektuar plotësisht në praktikë.
- Financimi i ARr nuk është i mjaftueshëm. Nuk ekziston një linjë e veçantë buxhetore për ARr dhe burimet publike mbulojnë kryesisht arsimin kompensues dhe trajnimet në QAP. Sistemi varet në masë të madhe nga projektet e financuara nga donatorët dhe tarifat e pjesëmarrësve, duke e lënë atë të fragmentuar dhe të paqëndrueshëm, me alokime të ulëta brenda kornizës së PSAK.
- Pjesëmarrja e palëve të interesit në qeverisjen e ARr është deri diku e larmishme, me përfshirje formale të ministrive, agjencive, partnerëve socialë dhe donatorëve. Megjithatë, pjesëmarrja efektive mbetet e kufizuar për shkak të sfidave që lidhen me funksionimin joaktiv ose të dobët të strukturave përkatëse. OJQ-të, ndonëse luajnë rol aktiv në ofrim, nuk janë të përfshira në mënyrë formale në strukturat e qeverisjes, duke kufizuar gjithëpërfshirjen e dialogut politik.
- Monitorimi dhe siguri i cilësisë janë të mbuluara deri në një masë të caktuar. AKK validon kualifikimet dhe akrediton ofruesit, ndërsa AAPARr, APRK dhe Inspektorati i Arsimit kanë role mbikëqyrëse. Megjithatë, fokusi mbetet kryesisht në ofrimin formal publik, ndërsa monitorimi i programeve jopërfomale, të sektorit privat dhe të OJQ-ve mbetet i kufizuar, ashtu si edhe siguri i standardeve profesionale për mësimdhënësit, trajnerët dhe facilitatorët e ARr.
- Rezultatet dhe kualifikimet e ARr janë të lidhura me KKK përmes mekanizmave të AKK, përfshirë validimin dhe miratimin e kualifikimeve, akreditimin e ofruesve dhe zbatimin e NJMP. Megjithatë, ky integrim mbetet pjesërisht i zhvilluar për shkak të përdorimit ende të kufizuar të NJMP-së. Megjithatë, pritet që situata të përmirësohet përmes zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie për promovimin e NJMP-së.

KAPITULLI III: OFRIMI I ARSIMIT PËR TË RRITUR

Kapitulli i fundit përshkruan programet ekzistuese dhe llojet e ofrimit të ARr, duke përfshirë edhe informata mbi shërbimet mbështetëse që janë në dispozicion për t'u mundësuar nxënësve të rritur qasje dhe pjesëmarrje në mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Llojet dhe programet e Arsimit të të Rriturve

Pasqyra e programeve ekzistuese të ARr në Kosovë tregon një spektër të gjerë mundësish formale, joformale dhe informale, të dizajnuara për t'u përgjigjur nevojave të ndryshme të të nxënësve. Këto programe janë të lidhura ngushtë me MATP dhe iniciativa të tjera strategjike, përfshirë praktikën profesionale, masat për vetëpunësim dhe përpjekjet e synuara për avancim dhe rikualifikim, me qëllim rritjen e punësueshmërisë, mbështetjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe promovimin e përfshirjes sociale të popullsisë së rritur. Në vijim paraqitet një përmbledhje e llojeve kryesore të programeve të ARr që ofrohen aktualisht në Kosovë, përfshirë ofruesit përkatës, formën e certifikimit ose kualifikimit që ofrojnë, si dhe lidhjen e tyre me politikat përkatëse në [Shtojcën VII](#).

Arsimi bazë kompensues

Arsimi bazë kompensues përbën një program të 'mundësisë së dytë' për të rriturit që kanë braktisur sistemin e rregullt arsimor. Ky program ofrohet nga shkollat publike dhe organizohet nga komunitet, nën mbikëqyrjen e MASHTI-t. Programi përfshin klasat 1–9 të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, si dhe klasat 10–13 të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë AAP. Të rriturit kanë mundësi të përfundojnë dy vite të arsimit të rregullt brenda një viti kompensues, duke ndjekur gjithsej 18 javë mësimore. Kur numri i pjesëmarrësve është më i vogël se 12, shkollat obligohen të ofrojnë së paku mësim në formë konsultative, ku pjesëmarrësit ndjekin 10% të orëve të planifikuara të kontaktit. Çdo shkollë harton një plan dhe kalendar vjetor, ku përcaktohen kurrikula, mësimdhënësit, provimet, praktika profesionale dhe aktivitetet e tjera përkatëse. Certifikatat dhe diplomat e lëshuara përmes arsimit kompensues janë të barasvlershme me ato të fituara në sistemin e rregullt.

Programe trajnimi që çojnë në një kualifikim të plotë ose të pjesshëm në KKK

Këto programe përfshijnë AAP, si dhe mundësi për përmirësim dhe rikualifikim të aftësive, të cilat janë të harmonizuara me nevojat e tregut të punës. Ato janë të validuara zyrtarisht dhe të regjistruara në KKK dhe mund të ofrohen si kualifikime të plota ose si module të pjesshme. Këto programe ofrohen nga ofrues publikë dhe privatë të trajnimeve, ndërmarrje, OJQ dhe shkolla të AAP-së, të cilat janë të akredituara nga AKK. KKK dallon tre lloje kualifikimesh që përfshijnë arsimin e të rriturve: Kualifikimet Kombëtare Profesionale (KKP), kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare dhe kualifikimet e përshtatura. Nga gjithsej 212 kualifikime të validuara dhe të aprovuara të listuara në KKK, më shumë se 75% (163) i përkasin arsimit të të rriturve, duke përfshirë kryesisht KKP-të dhe kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare.

- KKP-të zhvillohen nga SP kombëtare, miratohen nga KAAPARr dhe lidhen me kreditë e Sistemit Evropian të Krediteve për Arsim dhe Trajnim Profesional (ECVET) (nivelet 2–5 të KKK). Certifikatat mund të jepen për përfundim të plotë ose të pjesshëm. Aktualisht, janë miratuar 131 OS¹⁴ dhe 127 KKP, me 72¹⁵ ofrues të akredituar që i ofrojnë ato në sektor të ndryshëm ekonomik. Nga 163 KKP-të, vetëm dy ofrohen nga QK-të, duke reflektuar rolin modest të shkollave të AAP-së në ofrimin joformal të ARr-së¹⁶. Po ashtu, dy ofrues të sektorit privatë të janë akredituar për të ofruar KKP-të përmes MVP-së, ndërsa asnjë institucion publik aktualisht nuk ofron KKP-të për të rriturit përmes MVP-së¹⁷.

¹⁴ Lista e SP-ve të aprovuara: <https://akkks.rks-gov.net/Documents?idType=1018>.

¹⁵ Lista e ofruesëve të akredituar <https://akkks.rks-gov.net/Documents?idType=102>.

¹⁶ Ibid

¹⁷ Të dhëna të ofruara nga AKK.

- Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare përdoren në rastet kur nuk ekzistojnë standarde profesionale kombëtare, veçanërisht në fusha si TIK-u dhe kontabiliteti (Danuza et al., 2021). Këto duhet të validohen nga KKK dhe janë miratuar nga AKK; deri më sot, 36 kualifikime të tilla janë regjistruar, të ofruara nga 12 ofrues të akredituar¹⁸.
- Kualifikimet e përshtatura janë hartuar për të përmbushur nevojat e organizatave ose ndërmarrjeve specifike dhe, ashtu si kualifikimet e tjera, duhet t'i nënshtrohen validimit dhe akreditimit të ofruesit.

Programe të Aftësimit Profesional

Këto programe fokusohen në rikualifikim, ngritje të aftësive dhe zhvillim profesional dhe zakonisht ofrohen nga ofrues publikë dhe privatë të trajnimit, ndërmarrje, kompani dhe OJQ. Edhe pse nuk janë të miratuara nga KKK dhe për rrjedhojë nuk çojnë në kualifikime të njohura në nivel kombëtar, ato mund të njihen brenda sektorëve të caktuar.

Për shembull, programet e trajnimit të ofruara nga IKAP për nëpunësit civilë ose nga QAP-të për punëkërkuesit¹⁹. Në varësi të programit, pjesëmarrësit mund të pajisen me certifikatë të arritjes, bazuar në rezultatet e vlerësimit, ose me certifikatë të pjesëmarrjes. Këto programe kanë dëshmuar të jenë relevante për adresimin e nevojave sektoriale për aftësi dhe për përmirësimin e punësueshmërisë së të rriturve.

Një pasqyrë mbi numrin e pjesëmarrësve në këto programe gjatë periudhës 2022–2024 mund të gjendet në [Shtojcën VIII](#).

Mundësi të të Mësuarit Joformal dhe Informal

Këto programe mbulojnë qytetarinë aktive, shpesh të referuara si arsim komunitar, popullor ose liberal. Temat e mbuluara përfshijnë demokracinë, të drejtat e njeriut, integritimin evropian, shëndetin, ndërmarrësinë dhe zhvillimin kulturor, si dhe aktivitete rekreative dhe për zhvillim personal, si vallëzimi, joga dhe meditimi, dhe trajnime të tjera profesionale. Ato zakonisht ofrohen në formë trajnimesh, punëtorish, seminaresh, sesionesh ose vizitash studimore, nga OJQ-të, ndërmarrjet dhe ofruesit e trajnimeve.

Një iniciativë e rëndësishme në këtë fushë është themelimi i Qendrave për Arsim dhe Edukim të të Rinjve dhe të Rriturve në Prizren, Pejë dhe Vushtri, me mbështetjen e DVV-së dhe autoriteteve komunale, sipas modelit gjerman Volkshochschulen. Këto qendra ofrojnë të nxëniet gjatë gjithë jetës në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes programeve joformale, si gjuhët, marketingu digjital, udhërrëfimi turistik, joga, menaxhimi i eventeve dhe kurse të aftësive të buta. Ato reflektojnë një angazhim fillestar drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe të orientuar nga komuniteti në ARr, duke mbështetur jo vetëm zhvillimin e aftësive profesionale, por edhe zhvillimin personal.

Masat dhe shërbimet mbështetëse për kandidatët e rritur

Shërbime të informimit, ndërgjegjësimit dhe validimit

Ndërgjegjësimi dhe informimi për ARr në Kosovë mbetet i fragmentuar. Nuk ekziston një regjistër gjithëpërfshirës kombëtar i të gjithë ofruesve dhe programeve të ARr, gjë që e vështirëson identifikimin e mundësive nga ana e të rriturve. Aktivitetet e informimit realizohen kryesisht përmes iniciativave të bazuara në projekte, fushatave të ndërgjegjësimit, shoqërisë civile dhe së fundmi përmes rrjetit joformal të sapokrijuar RrAAPK. Një iniciativë e rëndësishme është Java e të mësuarit gjatë gjithë jetës, e organizuar çdo vit nga MASHTI në bashkëpunim me partnerë, e cila synon të promovojë pjesëmarrjen në arsimin gjatë gjithë jetës dhe të rrisë ndërgjegjësimin publik për rëndësinë e tij.

¹⁸ ibid

¹⁹ Ndërsa QAP-të shprehin interes të qartë për të ofruar programe të harmonizuara me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), ato shpesh përballen me vështirësi në përmbushjen e kërkesave të AKK-së për akreditim, veçanërisht sa i përket burimeve njerëzore (stafit të kualifikuar) dhe pajisjeve adekuate.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, mbulimi mbetet i pabarabartë dhe shpesh varet nga mbështetja e donatorëve.

Validimi i të mësuarit paraprak është i harmonizuar me KKK. Ju mundëson të rriturve që të vlerësojnë dhe të njohin mësimin e fituar në mënyrë joformale dhe informale, ndërsa zbatimi në praktikë lidhet kryesisht me AAP dhe trajnimet për të rritur, të lidhura me standardet e profesionit.

Programet dhe shërbimet aktive të tregut të punës

Programet aktive të tregut të punës në Kosovë ofrohen kryesisht përmes APRK-së dhe tetë QAP-ve të vendosura në Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Prishtinë dhe Gjakovë. Ato ofrojnë trajnime profesionale, rikualifikim dhe ngritje të aftësive për të rritur të papunë, punëkërkes dhe persona që synojnë integrimin ose ri-integrimin në tregun e punës. Në nivel të QAP-ve, gjatë vitit 2024 janë ofruar gjithsej 51 programe trajnimi, që mbulojnë fusha si hoteleria, ndërtimtaria, TIK, administrata dhe shërbimet personale. Prej tyre, trembëdhjetë kualifikime janë validuar dhe regjistruar në KKK, tetë janë në proces të rregullt validimi dhe dhjetë janë në procesin e NJMP, duke e sjell numrin total të kualifikimeve të validuara ose në proces në 31. Sa i përket rezultateve, 2,104 të rritur u regjistruan në trajnime profesionale gjatë vitit 2024, nga të cilët 1,545 (73%) u certifikuan me sukses²⁰. Pjesëmarrja është më e lartë te të rinjtë e moshës 15–24 vjeç (39% e pjesëmarrësve), megjithëse përfaqësohen edhe të rriturit deri në grupmoshën 55+ (3.1%). Megjithatë, sfidat në kapacitetet vazhdojnë, pasi qendrat shpesh nuk kanë trajnerë të mjaftueshëm për të përmbushur plotësisht standardet e akreditimit të AKK-së.

Shërbimet e orientimit dhe këshillimit në karrierë

Orientimi në karrierë në Kosovë ofrohet për të rriturit përmes sistemeve të arsimit dhe punësimit, megjithatë zbatimi në praktikë mbetet i pabarabartë dhe i paqëndrueshëm. APRK ofron këshillim në karrierë përmes zyrave komunale të punësimit dhe QAP-ve. Punëkërkesit regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Punësimit dhe grupohen sipas rrezikut për papunësi afatgjatë - i ulët, i mesëm ose i lartë. Këshilltarët përdorin të dhënat e profilizimit për të ofruar orientim të individualizuar dhe për t'i lidhur të rriturit me programe të ngritjes së aftësive, rikualifikimit ose ri-qasjes në tregun e punës. Në sistemin e arsimit, orientimi në karrierë është i integruar në shkollat e AAP dhe është zyrtarisht i qasshëm edhe për të rriturit e regjistruar në programe kompensuese ose profesionale. Fillimisht i mbështetur nga projekti EYE, dhe më pas vetëm nga MASHTI, nga viti 2022 janë themeluar gjithsej 26 qendra të orientimit në karrierë në shkollat e AAP, paralelisht me zhvillimin e kualifikimit të Këshilltarit të Karrierës në Nivelin 5 të KKK. QK në Prizren është akredituar për ofrimin e këtij kualifikimi dhe deri në vitin 2025 janë kualifikuar 104 këshilltarë të karrierës përmes shtatë grupeve trajnuese²¹. Platforma Busulla.COM ofron informacion mbi rrugët e të nxënësve dhe të karrierës dhe është e hapur edhe për të rriturit.

Pavarësisht këtyre strukturave, shtrirja drejt grupeve të cenueshme të të rriturve (si gratë në zonat rurale, të papunët afatgjatë dhe minoritetet) mbetet e kufizuar.

²⁰ Të dhëna të ofruara nga APRK.

²¹ Të dhëna të ofruara nga QK në Prizren.

Përfundime

Anët e forta

- Është arritur përparim i konsiderueshëm në integrimin e ARr në KKK, ku shumica e kualifikimeve të validuara dhe të miratuara i përkasin ARr.
- ARr është i ndërlidhur ngushtë me MATP-të, me QAP-të dhe APRK që ofrojnë trajnime për punëkërkesit dhe ri-integrimin në tregun e punës.
- Qendrat për Arsim dhe Edukim të Rinjve të themeluara së fundi ofrojnë programe joformale gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në komunitet, duke zgjeruar mundësitë për zhvillim profesional dhe personal për të rriturit.
- Ofrimi i ARr është i harmonizuar me KKK, me një gamë të gjerë kualifikimesh dhe certifikimesh të akredituara që sigurojnë njohje dhe cilësi në ARr.
- Orientimi në karrierë në ARr është fuqizuar përmes themelimit të qendrave të orientimit në karrierë në AAP dhe ofrimit të kualifikimit të Këshilltarit të Karrierës në Nivelin 5 të KKK, me mbi 100 këshilltarë të trajnuar deri në vitin 2025.

Sfidat

- Ofrimi i ARr përqendrohet kryesisht në rritjen e punësueshmërisë dhe rikualifikimin, ndërsa dimensionet e zhvillimit personal dhe mësimin në komunitet mbeten të kufizuara.
- Ndërgjegjësimi dhe informimi për mundësitë e ARr janë të fragmentuara dhe të kufizuara, veçanërisht për grupet e marginalizuara, popullsinë rurale dhe të rriturit e moshës më të shtyrë.
- NJMP është i rregulluar dhe metodologjikisht i avancuar, por niveli i zbatimit mbetet i ulët.
- Mungon një bazë kombëtare e të dhënave që mbështet zgjedhjet e informuara të të rriturve në lidhje me ARr.
- Shumica e shërbimeve plotësuese mbështeten në projekte dhe financim nga donatorët, duke kufizuar qëndrueshmërinë dhe duke sjell mbulim të fragmentuar në nivel kombëtar.

Gjendja aktuale

- ARr në Kosovë ofrohet përmes një game të larmishme programesh formale dhe joformale, që synojnë të rriturit që kanë braktisur arsimin fillestar, punëkërkesit, të punësuarit që kanë nevojë për rikualifikim ose përmirësim të aftësive, nëpunësit civilë, si dhe individët që kërkojnë zhvillim personal.
- Ofrimi i ARr adreson vetëm **pjesërisht** nevojat për diversitet, barazi dhe përfshirje të nxënësve të rritur. Arritja dhe përfshirja e grupeve të cenueshme mbetet e kufizuar, ndërkohë që edhe të nxënërit për zhvillim personal dhe qytetar vijon të jetë më pak i zhvilluar krahasuar me trajnimet e orientuara drejt tregut të punës. Megjithatë, ka progres përmes nismave komunitare si Qendrat për Arsim dhe Edukim të Rinjve.
- ARr ofrohet nga ofrues publikë të AAP, ofrues privatë, OJQ dhe ndërmarrje, ku programet formalisht të lidhura me KKK janë të rregulluara, ndërsa ofrimi joformal është më i larmishëm dhe kryesisht i nxitur nga sektori privat.
- Shërbimet mbështetëse si informimi dhe ndërgjegjësimi, këshillimi, orientimi në karrierë dhe validimi i aftësive ekzistojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin dhe rikualifikimin e aftësive; megjithatë, ato mbeten të fragmentuara dhe nuk funksionojnë si pjesë e një sistemi të integruar. Informimi dhe ndërgjegjësimi realizohen kryesisht përmes projekteve, ndërsa NJMP mbetet e zbatuar në masë të ultë.

PËRFUNDIME

Dimensioni I: Kuadri strategjik dhe ligjor

Kosova ka ndërtuar një kornizë ligjore dhe strategjike shumëdimensionale që e integron ARr në ligje dhe strategji kombëtare. Kjo kornizë mbështetet në KKK, SP dhe rregullimin e NJMP, si dhe është e integruar në strategjitë për arsim, punësim dhe digjitalizim. Megjithatë, mungesa e një strategjie të dedikuar për ARr ka rezultuar në mbivendosje dhe paqartësi, me theks të veçantë në arsimin dhe aftësimin profesional si dhe në arsimin kompensues, ndërsa më pak vëmendje i kushtohet të mësuarit gjatë gjithë jetës në kuptim më të gjërë, përfshirë zhvillimin personal, qytetar dhe komunitar. Zbatimi mbetet i paqëndrueshëm, veçanërisht në operacionalizimin e NJMP, ndërsa pjesëmarrja e përgjithshme vazhdon të jetë dukshëm nën mesataren e BE-së. Po ashtu, ekziston nevoja për të dhëna të harmonizuara dhe të përditësuara rregullisht për të mbështetur politikëbërjen e bazuar në dëshmi dhe për tregues që monitorojnë progresin kundrejt standardeve të BE-së. Megjithatë, progresi është i dukshëm në kuadër të reformave ligjore në zhvillim, ku projektligji në shqyrtim ofron një mundësi për të arritur një koherencë më të madhe dhe përputhje më të mirë me praktikën më të mira të BE-së.

Rekomandimi kyç është zhvillimi i një strategjie të integruar për ARr, ose përfshirja e një objekteve të veçantë për ARr brenda Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës, që do të sigurojë koordinim ndërsektorial, do të zgjerojë qasjen përtej arsimit dhe aftësimin profesional dhe do të vendosë theks në masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes, në përputhje me kornizat e BE-së.

Dimensioni II: Qeverisja dhe rregullimet institucionale

Qeverisja e ARr në Kosovë përfshin një gamë të gjerë akterësh, përfshirë ministri, agjenci, komuna dhe donatorë. Integrimi me KKK është i konsoliduar, ndërsa platformat e bashkëpunimit si RrAAPK janë në zhvillim. Megjithatë, zhvillimi i një sistemi efektiv të ARr kufizohet nga paqartësitë në ndarjen e roleve institucionale, koordinimi i dobët dhe mbivendosjet ndërmjet institucioneve, mungesa e organeve funksionale këshillëdhënëse, si dhe niveli i ulët i financimit. Varësia nga projektet e mbështetura nga donatorët e cenon qëndrueshmërinë, sidomos në mungesë të financimit publik të qëndrueshëm dhe të dedikuar për këtë fushë.

Për të fuqizuar qeverisjen, rekomandohet qartësimi dhe racionalizimi i roleve të palëve të interesit, formalizimi i mekanizmave këshillëdhënës shumëpalësh, si dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm dedikuar ARr.

Dimensioni III: Ofrimi i arsimit për të rritur

Ofrimi i ARr po zgjerohet gradualisht, duke shtrirë gamën nga arsimi formal kompensues dhe kualifikimet në AAP deri te programet e ndryshme joformale dhe të zhvillimit personal, me më shumë vëmendje kushtuar përmirësimit të aftësive, aftësive digjitale dhe grupeve të cënueshme. Është shënuar përparim i konsiderueshëm në integrimin e ARr në KKK, ku shumica e kualifikimeve të validuara tashmë i përkasin ARr. Ndër zhvillimet në vazhdim përfshihen zgjerimi i Qendrave për Arsim dhe Edukim të Rinjve, avancimi i zbatimit të NJMP dhe ofrimi i kualifikimit për udhëzimin në karrierë për praktikuesit. Megjithatë, shërbimet e informimit dhe të shtrirjes mbesin të fragmentuara. Sistemet ekzistuese të të dhënave janë të shpërndara në institucione të ndryshme, duke kufizuar shtrirjen dhe qasjen e të rriturve në informacion. Duke u mbështetur në arritjet ekzistuese, konsolidimi i mëtejshëm i sistemit dhe orientimi gradual drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse, që nxit pjesëmarrjen më të gjerë të të rriturve, do të kontribuojnë në avancimin e objektivave të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Rekomandimi kryesor është zhvillimi i një sistemi të integruar dhe të orientuar nga përdoruesi për menaxhimin e të dhënave dhe informacionit, i cili mundëson monitorimin e të gjitha formave të mësimit të të rriturve dhe ofron informim të qasshëm, të koordinuar, si dhe orientim gjatë gjithë jetës. Ky sistem do të mbështesë të rriturit në identifikimin dhe shfrytëzimin e mundësive për të mësuar, duke kontribuar njëkohësisht në planifikim më të mirë të bazuar në dëshmi.

SHTOJCA I – KORNIZA ANALITIKE DHE PYETJET UDHËZUESE

Kapitujt	Pyetjet udhëzuese [1]	Burimet/metodat
Hyrje - Konteksti i vendit (veçoritë qeveritare dhe administrative në fushën e arsimit dhe trajnimit, kornizat kryesore ligjore, pozicionimi i nën-sektorit të ARr brenda sistemit më të gjerë të arsimit dhe trajnimit) - Elemente specifike që lidhen me situatën politike të vendit, rregullimet kushtetuese, autonomitë territoriale/rajonale dhe juridiksionin mbi sektorin e arsimit - Prezantimi i strukturës dhe objektivave të dokumentit		Shqyrtim literature
Kapitulli 1. Strategjitë dhe politikat e ARr - Strategjitë kombëtare dhe rajonale për ARr (ekzistuese, të mëparshme dhe aktuale, ose në përgatitje dhe pritshmëritë për miratim) – qasja ndaj ARr (e gjerë, e ngushtë), objektivat kryesore strategjike, rezultatet e arritura deri më tani dhe synimet për t'u realizuar, analizë krahasuese e përputhshmërisë me prioritetet e politikave të BE-së, korniza ligjore ekzistuese; niveli i priorizimit që i atribuohet ARr, planet për reforma ose programe në shkallë të gjerë - Politikat kombëtare për ARr(përmbledhje e objektivave kryesore të politikave, masat kombëtare dhe rajonale të zbatuara ose në zbatim, popullata e synuar, boshllëqet e identifikuar në barazi dhe gjithëpërfshirje, burimet e financimit, pjesëmarrja e palëve të interesit, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimi - Synimet kombëtare kundrejt synimeve të BE-së (analizë e 5 treguesve kyç të Agjenda e Re Evropiane për ARr 2030 dhe Unionin e Aftësive 2030 në nivel kombëtar, si dhe tregues të lidhur me ARr nga Planet e Rritjes/Agjendat Kombëtare të Reformave	- Cilat janë prioritetet kryesore të strategjive kombëtare/rajonale ekzistuese për ARr? Ku synojnë ta çojnë ARr në vend? Aktualisht, a është ARr prioritet; a synon qeveria ta avancojë ARr; a avokojnë partnerët socialë dhe/ose akterë të tjerë joshqetërorë për progres në ARr? - A është korniza ligjore e përshtatur me strategjitë dhe objektivat e politikave kombëtare/rajonale? A i përgjigjen ato nevojave specifike të rajoneve? A ka mospërputhje ndërmjet niveleve të ndryshme të definimit të politikave (plotësisht/pjesërisht/aspak të harmonizuara)? - Cili është niveli i fragmentimit të politikave të ARr brenda sistemit më të gjerë të arsimit dhe trajnimit në vend (shumë i fragmentuar/i fragmentuar/jo shumë i fragmentuar)? - Cilët janë treguesit kryesorë në përdorim dhe synimet përkatëse për sektorin e ARr (p.sh., normat e pjesëmarrjes, nivelet e aftësive, rezultatet e punësimit)? - Kur është e mundur dhe relevante, krahasim me objektivat e politikave të BE-së në Agjenda e Re Evropiane për ARr 2030 dhe në Komunikimin për Unionin e Aftësive, si dhe me treguesit e krahasimit dhe synimet e tjera kombëtare (përputhen plotësisht/përputhen pjesërisht/nuk përputhen fare).	Shqyrtimi i literaturës Intervista Analizë e të dhënave
Kapitulli 2. Rregullimet institucionale dhe qeverisja e ARr Rregullimet institucionale (institucionet përgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal/rajonale; rolet dhe përgjegjësitë; organet e koordinimit; llojet e ofruesve – publikë/privatë/të tjerë; mbulimi territorial dhe boshllëqet në ofertën dhe	Cilat institucione janë përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e politikave të ARr, dhe si ndahen rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet ministrive, agjencive dhe akterëve të tjerë relevantë? Cilët mekanizma koordinimi ekzistojnë (p.sh. këshilli për ARr, komitet ndërmintor për ARr, Këshilli Ekonomik dhe Social, etj.) dhe cili është roli	Shqyrtimi i literaturës Intervista

kërkesën për ARr; pjesëmarrja e punëdhënësve dhe akterëve të tjerë nga bota e punës; burimet e financimit dhe modelet e financimit) ■ Modelet e qeverisjes së ARr (karakteristikat kryesore të modelit të qeverisjes, p.sh. i centralizuar/i decentralizuar, pjesëmarrës, bashkëvendimmarrës; diversiteti i akterëve; autonomia e ofruesve; proceset e mbikëqyrjes dhe koordinimit; lidhja me KKK-në) ■ Monitorimi dhe Sigurimi i Cilësisë, mbledhja dhe analiza e të dhënave për ARr, përfshirë vlerësimin	i tyre (këshillëdhënës, konsultativ, vendimmarrës 2. Cilat janë burimet kryesore të financimit të ofrimit të ARr? A ka partneritete publike–private të lidhura me financimin e ARr (p.sh. fonde trajnimi, lehtësime tatimore, taksa/kontribute, etj.)? A është modeli i financimit dhe burimet e financimit të mjaftueshme dhe adekuate (shumë adekuate / mesatarisht adekuate / fare jo adekuate 3. Cilët palë të interesit (p.sh. punëdhënësit, sindikatat, shoqëria civile, kandidatët/pjesëmarrësit) janë të përfshirë në planifikimin, dizajnimin, zbatimin dhe monitorimin e nismave të ARr, dhe në ç'masë ekziston pjesëmarrje e gjerë e akterëve relevantë në fushat e ndryshme të qeverisjes së ARr (diversiteti i lartë i palëve / disi i larmishëm / fare jo i larmishëm) 4. Sa e koordinuar është menaxhimi i zbatimit të politikave të ARr sipas rregullimeve institucionale të vendit? A janë ato në përputhje me kornizat ligjore të miratuara dhe a i përgjigjen një modeli më të centralizuar apo të decentralizuar (shumë i centralizuar / deri në një masë i centralizuar / i decentralizuar) 5. Deri në ç'masë njohja, transferueshmëria dhe integrimi i rezultateve/kualifikimeve të ARr janë të integruara/të lidhura me kornizat kombëtare të kualifikimeve/sistemet kombëtare të kualifikimeve (plotësisht e integruar / deri në një masë / fare jo e integruar)? 6. Cilët mekanizma (në nivel kombëtar/rajonar/dhe në nivel të ofruesve) ekzistojnë për të siguruar cilësinë e ofrimit të ARr? Si zbatohet monitorimi i rezultateve dhe cilat lloje programesh mbulohen? Si sigurohet cilësia e trajnerëve/lehtësuesve(plotësisht e mbuluar / deri në një masë / fare jo e mbuluar)	
Kapitulli 3. Ofrimi i ARr ■ Programet e ARr (programet kryesore ekzistuese formale dhe jofomale; shërbimet plotësuese si informimi/shtrirja, mentorimi, orientimi dhe këshillimi në karrierë, si dhe validimi i aftësive; përfshirja e një spektri të gjerë të nxënësve; objektivat dhe lidhja me iniciativat për rritje të aftësive dhe rikualifikim; llojet e ofrimit; iniciativat e fundit në fushën e ARr për grupe të veçanta të synuara; përvetësimi i aftësive) ■ Ofrimi i ARr (shtrirja/madhësia e ofrimit; numri i pjesëmarrësve të regjistruar; përqindja/numri i përfundimeve të programeve)	1. Cilat janë prioritetet kryesore të strategjive ekzistuese kombëtare/rajonale të ARr-së? Ku synojnë ato ta sjellin ARr-në në vend? Aktualisht, a është ARr-ja një prioritet, a synon qeveria të përparojë ARr-në, a avokojnë partnerët socialë dhe/ose akterë të tjerë jo-shtetërorë për progres në ARr? 2. A është korniza ligjore e përshtatur me strategjitë kombëtare/rajonale dhe objektivat e politikave? A korrespondojnë ato me nevojat specifike të rajoneve? A ka mospërputhje midis niveleve të ndryshme të përcaktimit të politikave (plotësisht/pjesërisht/aspak të përafruara) 3. Cili është niveli i fragmentimit të politikave të ARr-së brenda sistemit më të gjerë të arsimit dhe trajnimit të vendit (shumë i fragmentuar/i fragmentuar/jo aq shumë i fragmentuar)? 4. Cilat janë treguesit kryesorë në përdorim dhe objektivat përkatëse për ARr (p.sh., shkallët e pjesëmarrjes, nivelet e aftësive, rezultatet e punësimit) 5. Kur është e rëndësishme dhe e mundur,	Shqyrtimi i literaturës Intervista Analiza e të dhënave statistikore ?

	krahasojeni me objektivat e politikave të BE-së në Agjenda e Re Evropiane për ARr 2030 dhe Komunikatën mbi Unionin e Aftësive, si dhe treguesit e krahasimit dhe objektivat e tjerë kombëtarë. (përputhet plotësisht/përputhet pjesërisht/nuk përputhet fare)	
Konkluzion ■ Arritjet kryesore dhe çfarë po funksionon mirë, si dhe sfidat e identifikuar në secilin nivel (Kapitujt 1, 2 dhe ■ Veçantitë e gjetjeve për ARr, perspektivat në ARr dhe burimet e të nxënës nga politika ■ 1 deri në maksimum 3 përfundime kryesore që duhet të theksohen	1. Identifikimi i gjetjeve kryesore në secilin prej tre dimensioneve të analizës. 2. Çfarë tregon progresin (p.sh. një ligj i ri në përgatitje, rritje e financimit për ARr, përfshirja e akterëve jopublikë nga qeveria për mobilizim dhe kontribut në ARr, programe shumë të suksesshme, etj. 3. Cilat mbesin sfida ekzistuese dhe cilat janë sfidat e reja në zhvillim? 4. A i mbështesin gjetjet në pikat 1, 2 dhe 3 supozimet e studimit se ARr njihet si prioritet dhe se ka pro 5. Cilat janë burimet e “të nxënës nga politikat” (kush shërben si burim frymëzimi: vendet fqinje, vendet e BE-së, praktikat ndërkombëtare, etj.)?	Analizë e vetë ekspertit, e bazuar në informacionet kryesore cilësore dhe sasiore të mbledhura përmes shqyrtimit të literaturës dhe intervistave

[1] Këto pyetje udhëzuese janë përdorur si listë kontrolli për autorët gjatë hartimit të seksioneve të ndryshme të raporteve, veçanërisht në kutitë e Përfundimeve të secilit Kapitull – seksioni “Gjendja aktuale”.

SHTOJCAT II - LISTA E INTERVISTUESVE

Institucioni	Intervistuesi 1	Intervistuesi 2
DVV	Drejtör	
MASHTI	Udhëheqëse e Divizionit për Arsimin gjatë gjithë jetës	Zyrtare për arsimin joformal dhe arsimin për të rritur
APRK	Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim të Cilësisë dhe Certifikimit	
AAAPARr	Bashkëpunëtoe profesionale për çështje pedagogjike	
Shkolla "Emin Duraku"	Drejtör	
Qendra për Arsim dhe Edukim të të Rinjve	Drejtör	
EPALE Kosovo	Zyrtar Projekti – EPALE	

Burimi: Autori

SHTOJCA III – VLERËSIMI I REZULTATEVE TË ARRITURA: 2022 – 2024

Prioriteti	Masa	Treguesi	Rezultati
1. Përmirësimi i ofertës dhe pjesëmarrjes në ARr	1. Trajnimi i stafit mësimdhënës të ARr 2. Themelimi i Qendrave të ARr 3. Subvencione për ofruesit formalë 4. Mbështetje për grupet e cënueshme dhe të nënpërfaqësuar 5. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm për mësimdhënësit e AAP-së për ARr dhe NJMP 6. Zhvillimi i kurrikulave të ARr 7. Kualifikime modulare dhe kurse jofomale të ARr 8. Regjistri kombëtar i programeve dhe ofruesve të ARr 9. Fushata vetëdijesuese për ARr dhe Mësimin gjatë gjithë Jetës 10. Grupi ndërinstitucional i koordinimit për ARr 11. Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti	1. Numri i mësimdhënësve të trajnuar përmes programeve të akredituara për AR 2. Numri i qendrave funksionale të ARr 3. Numri i institucioneve përfituese; numri i nxënësve të mbështetur 4. Numri i bursave dhe masave afirmative 5. Numri i mësimdhënësve të trajnuar 6. Numri i kurrikulave të zhvilluara 7. Numri i programeve të zhvilluara/akredituara 8. Funksionaliteti i regjistrit 9. Numri i fushatave/pjesëmarrësve 10. Numri i takimeve dhe rezultatet e bashkëpunimit 11. Numri i mësimdhënësve/nxënësve që përfitojnë nga mobiliteti dhe projektet ndërkombëtare	1. Rreth 20 mësimdhënës të trajnuar; një program për përgatitjen e mësimdhënësve të ARr i akredituar 2. Dy qendra të themeluara (Prizren dhe Pejë) 3. Subvencione/grante rreth 300,000 € të shpërndara, duke përfshirë rreth 200 përfitues; shërbime falas për grupet e cënueshme 4. Bursa dhe stimuj të ofruar; shërbime falas për grupet shoqërisht të cënueshme dhe të nënpërfaqësuar 5. 20 mësimdhënës të AAP-së të trajnuar për ARr; 90 praktikantë të trajnuar për NJMP 6. Katër kurrikula të ARr të zhvilluara, dy të tjera të hartuara në vitin 2024 7. Dy programe të reja të akredituara (këshilltarë të karrierës, asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta); shtatë institucione të akredituara për NJMP 8. Platforma e menaxhuar nga AKK ekziston, por nuk ka të dhëna mbi përdorimin aktiv 9. Aktivitetet e organizuara: Java e ARr, ditë të hapura, konferencë vjetore e palëve të interesit 10. Rrjeti i ARr i themeluar, bord funksional me 4 takime koordinuese (2022–2023) 11. Rreth 20 mësimdhënës përfituan nga praktika/mobiliteti në vitet 2022–2023; progres në eksplorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar; nuk ka të dhëna për vitin 2024

SHTOJCA IV – ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË ARR NË KOSOVË

Institucioni	Përgjegjësitë
MASHTI	Miraton Strategjinë e PSAK-ut (objektivi për AAP dhe ARr); harton legjisllacionin primar dhe sekondar të lidhur me ARr; monitoron zbatimin e strategjisë dhe politikave të PSAK-ut; zhvillon kurrikula për ARr; akrediton programet e trajnimit për zhvillim profesional të mësimeve; administron SMIA (mbledh të dhëna vetëm për arsimin e mesëm profesional); përgatit buxhetin e shtetit për financimin e AAP-së (ARr).
MPMS	Harton, zbaton dhe monitoron politikat e punësimit dhe trajnimit profesional (MPAM); mbikëqyr punën e APRK-së; miraton buxhetin për APRK-në (MPAM).
APRK	Zbaton politikat e punësimit dhe trajnimit profesional; monitoron dhe koordinon zbatimin e MPAM-ve; zhvillon paketa kurrikulare në përputhje me KKK-në, përfshirë NJMP; përgatit analiza të nevojave të tregut të punës (jo në baza të rregullta); propozon iniciativa legjislative në fushën e punësimit dhe trajnimit profesional; mbikëqyr Kornizën Kombëtare të Klasifikimit të Profesioneve – Libri i Klasifikimit të Profesioneve
AAPARR	Administron dhe udhëheq QAP-të në aspektin financiar, të burimeve njerëzore, objekteve dhe infrastrukturës; zhvillon programe të ARr; koordinon studime në AAP dhe ARr; angazhon partnerët socialë në AAP dhe ARr.
KAAPARr	Përshtat programet e lëndëve të përgjithshme në AAP të mesëm për të rritur; këshillon Ministrin/Ministren e MASHTI-t për politikat e AAP dhe ARr; koordinon procesin e sigurimit të cilësisë së Standardeve të Profesionit (SP) dhe miraton SP-të në nivel kombëtar.
AKK	Zhvillon dhe mirëmban KKK-në; validon kualifikimet dhe akrediton ofruesit për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kualifikimeve; akrediton ofruesit për zbatimin e NJMP-së.
Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA)	Rekrutimi i stafit; administrimi i objekteve arsimore dhe buxhetit të shkollave; ngritja e kapaciteteve të mësimeve/instruktorëve dhe administratorëve.
Inspektorati i Arsimit	Inspektime pedagogjike dhe administrative të ofruesve të ARr.
Partnerët socialë	Përfshirje në hartimin e politikave kombëtare për ARr dhe AAP; pjesëmarrje në organet vendimmarrëse të AKK-së, KAAPARr-së dhe shkollave të AAP-së; zhvillim i SP-ve në bashkëpunim me palët relevante; lehtësim i praktikave. Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ndërmjetësim mes shkollave të AAP-së dhe ndërmarrjeve për mësim dual dhe MVP; lehtësim i bashkëpunimit dhe mbledhje e të dhënave për zbatimin e MVP/AAP dual
Këshilli Ekonomiko-Social (KES)*	Konsultime dhe rekomandime për politikat e punësimit, arsimin dhe trajnimit profesional; rol këshillues lidhur me Librin e Klasifikimit të Profesioneve.
Këshillat Sektoriale të Fuqisë Punëtore (pilotë të bazuar në projekte: TIK, përpunim druri, agrobiznes)	Mbledhje, analizë dhe validim i të dhënave mbi trendet e punësimit, kërkesën për shkathtësi dhe rritjen sektoriale; identifikim i mungesave/mospërputhjeve aktuale dhe të ardhshme të shkathtësive; rol këshillues në zhvillimin e kualifikimeve; lehtësim i dialogut të strukturuar mes punëdhënësve, ofruesve të trajnimit dhe politikëbërësve;

	platformë koordinimi sektoriale; ofrim feedback-u për politika.
Ofruesit e të nxënit të të rriturve	Ofrimi i të nxënit të të rriturve

* Jo funksionale

SHTOJCA V – PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL NË ORGANET E QEVERISJES, DREJTIMIT DHE KOORDINIMIT NË NËN-SEKTORIN E ARR

Institucioni pjesëmarrës	Bordi drejtues AAPARR ²²	KAAPARr	AKK-Bordi	Bordi Këshillëdhënës i APRK ²³
MASHTI	✓		✓	✓
AAPARR	✓*		✓	
AKK			✓*	✓
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	✓		✓	✓
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	✓	✓		
Ministria e Ekonomisë	✓		✓	
AKK		✓	✓	
MFLT	✓	✓	✓	✓
Oda Ekonomike	✓	✓	✓	
Ministria e Shëndetësisë	✓	✓	✓	
Shoqatat e Punëdhënësve	✓	✓	✓	✓
Ofruesit e AAP			✓	
Sindikatat	✓	✓		✓
Universitetet			✓	
OJQ në sektorin e AAP			✓	
Studentët me aftësi të kufizuara			✓	
Ministria e Bujqësisë	✓			
Kolegjiumi i drejtorëve të shkollave të AAP	✓*			
Drejtorë nga Shkolla e AAP nga sektori privat	✓*			
Asociacioni i komunave të Kosovës				✓

* Anëtar me të drejtë pjesëmarrjeje pa të drejtë vote

²² Organi nuk është rikonstituuar pas përfundimit të mandatit të parë.

²³ Organi nuk është konstituuar fare.

SHTOJCA VI – BURIMET E FINANCIMIT NGA BUXHETI I SHTETIT, NË NIVEL QENDROR DHE KOMUNAL

Burimi i financimit	Lloji i programit	Vëllimi i financimit
Buxheti i Kosovë mbulon detyrimet ligjërisht të detyrueshme	Programet për përfundimin e arsimit fillor për të rritur Programet për përfundimin e arsimit të mesëm të ulët për të rritur me arsim fillor të përfunduar Programet e trajnimit për punëkërkuues NJMP për punëkërkuues Programet e trajnimit për nëpunësit civilë Programet e trajnimit për zyrtarët e Policisë Programet e trajnimit për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës Procesi i verifikimit të Standardeve të Profesionit (SP) Funksionimi i institucioneve të themeluara nga shteti (QAP-të, shkollat fillore dhe të mesme të ulëta që ofrojnë arsim kompensues, shkollat profesionale që ofrojnë arsim kompensues, Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe AKK) Monitorimi i zhvillimit të ARr	Nuk ka të dhëna në dispozicion

SHTOJCA VII – PËRMBLEDHJE E OFRIMIT TË ARSIMIT TË TË RRRITURVE NË KOSOVË

Lloji i programit	Ofruesi	Certifikimi / Kualifikimi	I lidhur me politika
Diplomë e arsimit fillor	Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	Diplomë e arsimit fillor	Arsim kompensues
Kualifikim Kombinuar Kombëtar	Shkolla profesionale të mesme të larta	Certifikatë e Kualifikimit të Kombinuar Kombëtar	Arsim kompensues; Rikualifikim
Kualifikim Profesional Kombëtar	Ofrues të akredituar të aftësisë profesionale	Certifikatë (nivelet 2–5 të KKK)	AAP; KKK; NJMP; MAPT; rikualifikim; ngritje e aftësive; MVP / AAP dual
Kualifikim i bazuar në standarde ndërkombëtare	Ofrues të akredituar të aftësisë profesionale	Certifikatë (nivelet 2–5 të KKK)	KKK; rikualifikim; ngritje e aftësive; MVP / AAP dual
Kurse të shkurtra profesionale	Ofrues të aftësisë profesionale	Certifikatë e arritjes ose e pjesëmarrjes	Rikualifikim; ngritje e aftësive
Trajnime në shërbim për mësimdhënës	Ofrues trajnimesh të miratuar nga MASHTI*	Certifikatë e arritjes	Ngritje e aftësive
Trajnime për shërbimin publik	Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)	Certifikatë e arritjes ose e pjesëmarrjes	Ngritje e aftësive
Kursi i trajnimit Curriculum globALE për ARr	Fakulteti i Edukimit	Certifikatë e arritjes	Trajnim për mësimdhënës të ARr, ngritje e aftësive
Kurse për zhvillim personal	Ofrues trajnimesh; OJQ (p.sh. Qendrat për Arsim dhe Edukim të Të Rinjve)	Certifikatë e pjesëmarrjes (nëse aplikohet)	Mësim joformal; zhvillim qytetar dhe personal

* Këta ofrues mund të jenë gjithashtu organizata joqeveritare

SHTOJCA VIII – TABELA STATISTIKORE: PJESËMARRJA DHE CERTIFIKIMI

Institucioni	Certifikuar			Pjesëmarrës		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024
Të rriturit në AAP	1,865	830	1314	NA	NA	NA
AKK	9,698	1,0467	9169	NA	NA	NA
IKAP ²⁴	4,006	3,200	2301	5094	3,628	2,770
QAPs	2,165	2,192	1324	2797	2,928	1,777
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	/	952	893	1,057	2,501	1,659
Qendra Rinore (Peja dhe Prizren) ²⁵	/	/	/	/	/	386

²⁴ Të dhëna të ofruara nga IKAP.

²⁵ Të dhëna të ofruara nga DVV international në Kosovo.

AKRONIMET

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AAPARR	Agjencia për Arsimin dhe Trajnimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AARr	Arsimi dhe Aftësimi i të Rriturve
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ARr	Arsimi i të Rriturve
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtore të Komunalit të Arsimit
EPAL	Platforma Elektronike për Arsimin e të Rriturve në Evropë
ETF	Fondacioni Evropian i Trajnimeve
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
JETA	Përsheptimi i Tranzicionit të Drejtë dhe të Barabartë
KAAPARr	Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
KES	Këshilli Ekonomik dhe Social
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KKP	Kualifikimet Kombëtare Profesionale
LLL	Mësimi gjatë Gjithë Jetës
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MATP	Masa Aktive të Tregut të Punës
MCA-KS	Millennium Challenge Account – Kosovë

MCC	Millennium Challenge Corporation
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NEET	Jashtë punësimit, arsimit dhe trajnimit
NJMP	Njohja e Mësimit Paraprak
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
QAP	Qendër e Aftësimit Profesional
QK	Qendër e Kompetencës
RrAAPK	Rrjeti i Arsimit dhe Edukimit të të Rriturve në Kosovë
SNKA	Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit
SP	Standarde Profesionale
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UA	Udhëzim Administrativ
ZhpV	Zhvillim Profesional i Vazhdueshëm

REFERENCAT

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës – APRK. (2025). *Të dhëna administrative mbi ofrimin e arsimit dhe trajnimit për të rritur*, të ndara me autorin më 9 shtator 2025.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2024). *Regjistrimi i Popullsisë 2024 – Rezultatet paraprake*. Prishtinë: ASK. Qasja e fundit më 5 nëntor 2025, në: <https://ask.rks-gov.net>.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2024). *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023*. Prishtinë: ASK. Qasja e fundit më 7 gusht 2025, në: <https://ask.rks-gov.net>.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2024). *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2024*. Prishtinë: ASK. Qasja e fundit më 7 gusht 2025, në: <https://ask.rks-gov.net>.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). *ASKdata – Portali Zyrtar i të Dhënave Statistikore* [online]. Qasja e fundit më 28 gusht 2025, në: <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>.
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve – AKK. (2025). *Të dhëna administrative për ofruesit dhe kualifikimet e akredituara*. Të dhëna administrative të papublikuara, të pranuar më 2 shtator 2025.
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve – AKK. (2025). *Të dhëna mbi numrin e praktikuesve të NJMP të trajnuar nga AKK*. Të dhëna administrative të papublikuara, të pranuar më 2 shtator 2025.
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). (n.d.). *Lista e ofruesve të akredituar*. Qasja e fundit më 29 gusht 2025, në: <https://akkks.rks-gov.net/Documents?idType=102>.
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). (n.d.). *Lista e Standardeve Profesionale (SP) të miratuara*. Qasja e fundit më 29 gusht 2025, në: <https://akkks.rks-gov.net/Documents?idType=1018>.
- Danuza, T., Pfanzelt, A., & Pfanzelt, H. (2021). *Qualitative Study on Adult Education in Kosovo*. German Adult Education Association / DVV International. Qasja e fundit më 20 korrik 2025, në: https://www.dvv-international.ge/fileadmin/files/caucasus-turkey/Kosovo/Resources/STUDY_Kosovo_English.pdf.
- DVV International Kosovë. (2025). *Të dhëna administrative mbi programet dhe ofruesit e arsimit për të rritur*. Të dhëna të papublikuara, të pranuar më 21 gusht 2025.
- DVV International. (2021). *Adult Learning and Education Network in Kosovo (ALE-NK): Advocacy Document*. Prishtinë: DVV International. Qasja e fundit më 6 gusht 2025, në: https://www.dvv-international.ge/fileadmin/files/caucasus-turkey/Kosovo/Resources/Advocacy_document_ALE_Kosovo.pdf.
- European Training Foundation (ETF) (2024). *Key policy developments in education, training and employment - Kosovo 2024*. Turin: ETF. në: <https://www.etf.europa.eu/en/document-attachments/key-policy-developments-education-training-and-employment-kosovo-2024>.
- European Training Foundation (ETF). (2021). *Country Fiche: Kosovo 2021*. Turin: ETF. Qasja e fundit më 1 gusht 2025, në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/document/CFI_Kosovo_2021.pdf.
- European Training Foundation (ETF). (2022). *National Career Development Support System Review – Kosovo*. Turin: ETF. Qasja e fundit më 1 gusht 2025, në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2022-07/Career%20Guidance%20Review_Kosovo_EN.pdf.
- European Training Foundation. (2023). *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the Weak Links*. Raporti përfundimtar, mars 2023. Qasja e fundit më 4 gusht 2025, në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2023-05/RED%20Kosovo%20-%20final%20report_for%20dissemination.pdf.
- Eurostat. (2024). *Labour Market and Demography Statistics*. Bruksel: Eurostat. Qasja e fundit më 20 korrik 2025, në: <https://ec.europa.eu/eurostat>.

Helvetas Kosovë. (2024). *Orientimi në tregun e punës përmes këshillimit për karrierë të bazuar në shkollë në Kosovë: Studim rasti mbi projektin EYE*. Qasja e fundit më 14 gusht 2025, në: <https://www.helvetas.org/en/switzerland/how-you-can-help/follow-us/blog/education/case-study-on-school-based-career-guidance-in-kosovo>.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike – KIPA. (2025). *Të dhëna administrative mbi trajnimet për të rritur dhe programet e ngritjes së kapaciteteve*. Të dhëna të papublikuara, të pranuar më 5 shtator 2025.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2005). *Ligji Nr. 02/L-24 për arsimin dhe trajnimin e të rriturve*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L24_en.pdf.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-060 për kualifikimet kombëtare*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/11-ligji-kualifikimeve-2008-03-l-060-en.pdf>.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligji Nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17 (16 shtator 2011). në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/03-ligji-per-arsimin-parauniversitar-anglisht.pdf>.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2013). *Ligji Nr. 04/L-138 për arsimin dhe trajnimin profesional*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 7 (26 mars 2013). në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/ligji-per-aftesimin-profesional-2013-eng.pdf>.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2014). *Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 1/2014. në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8983&langid=2>.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2015). *Ligji Nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2 (8 janar 2016). në: http://www.pppkosova.org/repository/docs/35.%20LAW_NO.05_L-018_ON_STATE_MATURA_EXAM.pdf.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). (2014). *Udhëzim Administrativ Nr. 31/2014 për Njohjen e Mësimi Paraprak (NJMP)*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10257>.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MEST). (2019). *Udhëzim Administrativ Nr. 09/2019 për kriteret dhe procedurat e akreditimit të institucioneve që zbatojnë NJMP*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). (2022). *Strategjia e Arsimit 2022–2026*. Qasja e fundit më 7 gusht 2025, në: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Eng-Web.pdf>.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). (2023). *Udhëzim Administrativ Nr. 12/2023 për Kriteret dhe Procedurat e Miratimit të Programeve të Zhvillimit Profesional për Mësimdhënës dhe Punëtorë të Arsimit*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=75496>.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). (2023). *Udhëzim Administrativ Nr. 13/2023 për Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=75515>.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). (2023). *Udhëzim Administrativ Nr. 14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën e Mësimdhënësve*. në: <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/06/Udhëzim-Administrativ-me-nr-14-rotated-1.pdf>.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). (2025). *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2024/2025*. Prishtinë: MASHTI. në: <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2024-2025>.

Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2025). *Economic Convergence Scoreboard for the Western Balkans 2025*. Paris: OECD Publishing.
në:https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/05/economic-convergence-scoreboard-for-the-western-balkans-2025_53d9169e/bc0babf3-en.pdf.

Qeveria e Kosovës. (2022). *Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rome dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024*.
në:<https://www.refworld.org/policy/strategy/natauth/2022/en/149824>.

Qeveria e Kosovës. (2023). *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031*.
në:<https://balkangreenenergynews.com/kosovo-outlines-energy-transition-until-2031-in-strategic-document/>.

Qeveria e Kosovës. (2024). *Agjenda e Reformave e Kosovës 2024–2027*. në:<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/RGF-Kosovo-Reform-Agenda.pdf>.

Qeveria e Kosovës. (2024). *Strategjia e Punësimit 2024–2028*. Prishtinë: Zyra e Kryeministrit.
në:<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Employment-Strategy-2024-2028.pdf>.

Qeveria e Republikës së Kosovës. (2013). *Rregullorja Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor të Qeverisë*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
në:https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/114legalopinion_PK52R5dVdM.pdf.

Regional Cooperation Council (RCC). (2021). *Digital Skills in the Western Balkans*. Sarajevë: RCC.
në:<https://www.rcc.int/download/docs/2021-09-Digital%20skills.pdf/93a12a4a5178324cb46c052cd5e24180.pdf>.

Republika e Kosovës. (2019). *Ligji Nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore (me ndryshimet e bëra)*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. në: [\t " _new.](https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15321)

World Bank. (2023). *Western Balkans Regular Economic Report No. 24, Fall 2023*. Washington, DC: World Bank. në:<https://openknowledge.worldbank.org/bitstreams/2f23a38d-6a1e-498e-8688-3018b29d1a7a/download>.